

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

**Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 179, Shtator 2018**

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## NJOFTIM

Anëtar e anëtare të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"! Aktivist e aktiviste të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"! Dukagjinat kudo ndodheni, në veçanti djem e vajza! Miq e mike të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"! Me datën 23 korrik 2018, ju kemi njoftuar, se Konferenca e VI e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" do të mbledhet, ditë e shtunë, me datën 15 shtator 2018, në ora 11. 00, në mjediset e Bibliotekës së Universitetit "Luigj Gurakuqi". Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", e mbledhur sot, me datën 7 shtator 2018, pasi analizoj punën e bërë për përgatitjen e mbledhjes së Konferencës VI të Saj, me qëllim, për përmirësimin e rrënjësishëm të punës së Shoqatës,

### VENDOSI

Mbledhja e konferencës së VI të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", të behet me datën 20 tetor 2018, ditë e shtune, në ora 11. 00, në mjediset e Bibliotekës së Universitetit "Luigj Gurakuqi". Bëjmë thirrje, që brenda muajit shtator 2018, pranë Kryesisë së Saj, të paraqiten kandidatë për Kryetar të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".  
*Kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Shkodër, me 7 shtator 2018*

## GJENDJA E PRONAVE NË ZONAT MALORE KËRKON NDËRHYRJE URGJENTE

Pas 27 vitesh në zonat malore, këtu kam parasysh Malësinë e Madhe, Pukën dhe Dukagjinin mbase, në të gjitha zonat malore të vendit, nuk është zbatuar Ligji 7501, datë 19.07.1991. Ndonëse janë pajisur pjesërisht me Aktin e Marrjes në Përdorim të Tokës (AMPT) që i njeh përdorimin e pronës, por jo pronësinë e saj. Banorët e këtyre zonave kanë arritur të marrin pronat e lëna trashëgim nga paraardhësit e tyre, tradicionalisht. Pasi Ligji të cilin e cituam më lart, nuk është zbatuar për shumë arsye. Pjesërisht do të analizojmë më poshtë...

## FAMILJA, GJËJA MË E SHITRENJTË

Një grua ishte shumë e sëmur. Ishte vetëm me të shoqin, në moshë të thyer që të dy. Fëmijët i kishin jashtë shtetit me punë të gjithë. Fëmijët merrnin në telefon herë pas here dhe interesoheshin për nënën e tyre. Po të bëhet më keq na merr në telefon urgjent, i thonë të atit. Në një moment, babai i tyre, përgjigjet gjithë nervozitet, "Nuk di, por e sëmur është boll, vdekë nuk kemi ndonjë herë as unë e as ajo, se ça është ka bahet nuk po di".

## TË KËNDOFTË ZEMRA NIKOLLË NIKPRELAJ

KONCERT MADHËSHTOR NGA KËNGËTARI NIKOLLË NIKPRELAJ, NË ZEMËR TË ALPEVE

## NJE JETE E RREFYER NE KUJTME

Shpesh harrojmë sesi orët, ditët dhe vitet ikin e tretën përtej në oqeanin e pafund të marramendjes, harrojmë se po harxhojmë kohë pa kandar dhe pastaj vjen një ditë që lutemi me shpirt t'i kemi e t'ju rikthehemi, por uji që rrjedhë nuk kthehet më kurrë. Nuk ka fatkeqësi më të madhe për një të moshuar që nuk ka çfarë të tregojë asgjë veç viteve, ky tip robi është vëlla me buallin, ...

## GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU, "MBRETI I ALBANËVE DHE EPIROTËVE" DHE PAL ÈJLLI, "KARDINALI I ALBANËVE DHE EPIROTËVE"...

*Me rastin e Konkursit për 550-vjetorin e vdekjes së heroit nacional Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Me rastin e 10-vjetorit të Përgjigjes së autorizuar nga Papa Benedikti XVI, drejtuar "Shoqatës Atdhetare Dukagjini" dhe "Shoqatës Integrimi në Evropë", në lidhje me materialin studimor mbi titujt e merituar realë, retrospektivë dhe honorifikë, për Gjergj Kastriotin Skënderbeun, "Mbret i Albanëve dhe Epirotëve" dhe për kryepeshkopin Pal Èjlli, "Kardinal i Albanëve dhe Epirotëve", shkruar nga studiuesi Agron Luka.*



# GJENDJA E PRONAVE NË ZONAT MALORE KËRKON NDËRHJRJE URGJENTE

Pas 27 vitesh ne zonat malore, këtu kam parasysh Malësinë e Madhe, Pukën dhe Dukagjinin mbase, në të gjitha zonat malore të vendit, nuk është zbatuar Ligji 7501, datë 19.07.1991. Ndonëse janë pajisur pjesërisht me Aktin e Marrjes në Përdorim të Tokës (AMPT) që i njeh përdorimin e pronës, por jo pronësinë e saj. Banorët e këtyre zonave kanë arritur të marrin pronat e lëna trashëgim nga paraardhësit e tyre, tradicionalisht. Pasi Ligji të cilin e cituam me lart, nuk është zbatuar për shumë arsye. Pjesërisht do ti analizojmë më poshtë. Dihet se sipërfaqet e tokës arë e pemëtore janë të copëtuara dhe të vogla. Kjo do të thotë se nuk ka sipërfaqe që të ndahet për frymë. Por edhe banorët, të cilët janë të lidhur me njëri tjetrin me qindra fije gjaku, miqësi, shoqërie etj nuk pranojnë të marrin pronat e njëri tjetrit. Po edhe sikur të ndodh që të marrin tokë në pronë e një personi tjetër, do kishte problem sociale, mbase do krijohen konflikte në të ardhmen. Jemi dëshmitar për problemet të bëra të njohura nga mediat e shkruara dhe ato vizive, për grindjet deri dhe vrasje për një vijë uji, për një gardh apo për një m2 tokë. Këto ngjarje kanë ndodhur edhe brenda familjes. Nuk mund të investojnë askush në pronën e tjetrit, të cilën e ka trashëgim nga gjyshërit e stërgjyshërit e tyre. Në shumë raste këto prona janë blerë shumë e shumë vite më parë. Pra nuk lejojnë që të tjerët t'i gëzojnë. Atje nuk bëhet fjalë për kompensim pronash etj. Po thuajse të gjithë banorët i njohin kufijtë e pronave të tyre që para kolektivizimit. Në vitin 1947, flasë për krahinën e Dukagjinit është matur e evidentuar sipërfaqja e tokës dhe është dhënë në ngarkim kryefamiljarëve të firmosur nga komisioni i matjes së tokës dhe kryefamiljari. Përveç tokës arë e pemëtore këtu janë matur e dorëzuar edhe livadhet, të cilat gjatë periudhës së kolektivizimit u mbollën me pemë frutore e tani kualifikohen pemëtore. Nuk është rastësi kur një banor nga Thethi, interesohet për pronat e tij. Paraqitet në Kadastrën e Shkodrës për marrë hartat e vitit 1947. Pasi bëhen matjet ajrore, duke i krahasuar me ato të 70 viteve më parë, lëvizin vetëm pak m2. Në këto matje gjënë edhe me cilën familje kufizohet të përcaktuara shumë saktë sipas parcelave. Është absurditet që të mos jesh pronar i pronës të pa luajtshme, të trashëguar në shekuj. Ky fenomen ka ndikuar e po ndikon negativisht në zhvillimin e këtyre zonave. Është pikërisht mos

pajisja me dokumente të pronësisë. Ajo që ka mbajtur e po mban peng zhvillimin e këtyre zonave. Pa sigurinë e të drejtave, mbi pronën, e cila prek zonat veriore e mbase edhe me gjerë, dhe marrja e pronësisë ligjore, bëhet pengesë për ata të cilët e kanë në shfrytëzim tokën, të veprojnë në tregun formal të pronave, apo ti përdorin pronat si kolateral për të marrë kredi pran bankave. Nuk mund të marrë kompensim në raste të shpronësimit, etj. Ndonëse de fakto ata janë pronarë, pra e punojnë tokën, marrin prodhimet e tyre i konsumojnë ose i shesin, por nuk kanë mundësi të bëjnë investime të ligjshme. Nuk kanë të drejtë ta shesin, as ta japin me qira tokën. Por çfarë po ndodh në fakt? Në mjaft raste, thuhet se, toka është shitur, madje blerësi ka bërë investime për shuma të mëdha. Po këto janë bërë me letra dore, të cilat nuk kanë asnjë vlerë ligjore. Ky është një guxim i tepruar se mund të ndryshojnë fjalët, pastaj lindin konflikte deri aty sa mund të kush-

në përdorim, ku mund të bëhen shumë abuzime. Ka raste që toka është shitur e personi sigurohet si i vetëpunësuar në bujqësi, pa pronësinë mbi tokë, pasi nuk kanë atë të shkretë certifikatë pronësie. Kjo ndikon drejt për së drejti në shkeljen e të drejtës së pensionimit, edhe në disa favorizime të tjera, si kujdesi shëndetësor, etj. Nuk mund të afrohen investitorët vendas as të huaj, pasi nuk mund të merret leje për ndërtime të reja, që janë të domosdoshme, sepse prona e trashëguar në shekuj nuk është e ligjshme. Si mund të bëhen legalizimet e banesave të reja apo të rikonstruara kur mungon pronësia ligjore. Ka ardhur koha që të gjendet një mënyrë për të bërë njohjen e pronësisë së tokës dhe në tërësi të pasurisë së paluajtshme. Duhet bërë një gjë, duhet gjetur zgjidhja edhe për këto zona duke u hap një dritë jeshile për të jetuar. Janë me qindra familje të cilat ishin zhvendosur pas viteve 90 në qytete apo rrethina të tyre, qo po kthehen në këto zona, pra janë kthyer

konflikte e boshllëqe të rëndësishme në kuadrin ekzistues ligjor, për të hequr ngushticat të cilat mbajnë peng proceset e regjistrimit të titujve të pronësisë.

Kërkohet përsheptimi i procesit të regjistrimit fillestar, duke marrë në konsideratë specifikat e zonave, ndarjen faktike të tokës sipas pronave të paraardhësve të tyre, para kolektivizimit të bujqësisë. Hedhja e pronave të këtyre zonave në sistemin e regjistrimit të tokave si një hap i rëndësishëm për zbutjen e gjendjes sociale. Duhet bërë me shumë punë që banorët të njihen me parashikimin ligjor për regjistrimin e të drejtës së pronës. Sa do të flasim apo të shkruajmë, shkojnë bosh, në qoftë se nuk ndërhyjnë Qeveria, prandaj ajo duhet të marrë masa, duke e kthyer vëmendjen të këto zona të lëna në harresë. Të shfrytëzohen resurset dhe magjtitë e "bukurisë" potencialet e panumërta në favorin e banorëve të këtyre zonave e më gjerë. Kjo arrihet vetëm



tojnë edhe jetë njerëzish. Mungesa e pronësisë ka bërë që banorët e këtyre zonave të mos përfitojnë subvencionime nga shteti. Në zonat turistike janë bërë shumë ndërtime, hotele e bujtina, të cilat presin me qindra vizitor, duke përfituar edhe të ardhura të konsiderueshme. Kjo ka çuar në rritjen e punësimit të banorëve, por punojnë në informalitet të plotë. Ata nuk mund të sigurohen si të vetëpunësuar në bujqësi. Vetëm me aktin e marrjes së tokës

e pop kthehen në shtëpitë e tyre, të cilat ligjërisht nuk u njihen si të tyre. Gjithsesi duhet përsheptur Vendimi i Qeverisë, për legalizimin e ndërtimeve para vitit 1991. Problemet e tani shme nuk janë të pa korrigjueshme dhe mund të trajtohen nëpërmes një politike koherente që të synojë një zgjidhje të plotë sa më të shpejtë, bazuar në një mbështetje të gjerë nga politika dhe nga shoqëria. Një zgjidhje e tillë do të duhej të trajtojnë disa

me një vendim qeveria ku regjistrimi i tokës të bëhet sipas kufijve të vjetër. Banorët e këtyre zonave tu gëzohen juridikisht pasurive të pa tundshme të tyre, të lëna trashëgim nga paraardhësit e tyre. Shpresojmë që kjo punë të fillojë dhe të përfundojë sa më parë.

**Ndue ZIÇI**  
**Luigj SHYTI**

# NJE JETE E RREFYER NE KUJTIME

Shpesh harrojmë sesi orët, ditët dhe vitet ikin e treten përtej në oqeanin e pafund të marramendjes, harrojmë se po harxhojmë kohë pa kandar dhe pastaj vjen një ditë që lutemi me shpirt t'i kemi e t'ju rikthehemi, por uji që rrjedhë nuk kthehet më kurrë. Nuk ka fatkeqësi më të madhe për një të moshuar që nuk ka çfarë të tregojë asgjë veç viteve, ky tip robi është vëlla me buallin, plak që s'ka çfarë të tregojë veç numrit, rrathëve vjetor të gdhendur në brirë. Ndreke Dede Guri është trefish i përfaqësuar nga fati, ka kaluar të tetëdhjetat dhe ka huret e një gjashtëdhjetëvjeçari. Saga e jetës së tij është një maratonë e gjatë me pengesa që kapërcen tre regjime dhe tre kontinente. Ai është një luftëtarë që sfidoi drama të mëdha, i thyen krahët dhe u ngrit përsëri në fluturim, e shtynë drejt greminës, por nuk e rrëzuan dot, ia nxunë hisen e diellit, madje jo vetëm mbijetoi, por i mori jetës më të mirat e mundshme. Tashme i qetë afër finishit ka gjithë sinqeritetin, talentin dhe mjeshtërinë e duhur për të rrëfyer kujtimet e motit të shkuar. Pasi lexova dhe e rilexova „dorëshkrimi i librit e konfirmoi me bindje të plotë se kryefjala dhe kallëzuesi e këtij libri është vërtetësia dhe çiltërsia e rrëfimit të autorit.

Ky libër nuk është një autobiografi, as monografi me strukturë standarde, por një proze historike e auto-rrëfyer, e përthyer tek-tuk me poezi. Autori në asnjë rresht nuk mundohet t'i veshë vetës një qyrk jashtë masës së tij trupore. Në asnjë rast nuk rrëfen broçkulla, nuk merr poza martiri, patrioti as shenjtori të pa mëkate.

Nuk di të vetëmburret si i dijsëm, as për arritjet personale dhe familjare sipas postulatit:

- "Kush qene e ka për te qenë" ! Unë jam Ndreka, Deda Mhilli, Kola, Nika Martini Prela ... K'ta janë shtatë brezat ma të afërt të trungut tonë familjarë, të cilët kanë lindë, dhe kanë jetue në Brashtë të Shoshit (Dukagjin) për disa shekuj me radhë. Me këto fjale nise fillin e kujtimeve autori i cili tregon me radhe gjeneratën bijë, bija, nipa, mbesa e sternbesa, sternipa miq te vjetër e të rinjë, të gjallë e të vdekur me hise e pa hise. Kjo është Brashta jeme e vjetër sa ashta qe i mori emrin, e shtrenjtë si drita, e dashur sa jeta që me fali. Kjo është kulla e të preve e ngritur afër Gurit të Ulnikës, mbi të cilin pushon ora dhe lokja e përkundi djepin duke kënduar ninulla përkundrejt gjithë Shoshit oazit më të dashur të gjithë rruzullimit. Autori mban familjarisht si mbiemër atë gur, pasi ne diktature e pagëzuan me detyrim përcaktim, dhe vërtetë me atë gur e lidhin shume kujtime ndaj e do me tepër gjithë gurët e maleve së bashku. Autori me një përshkrim të thjeshtë, pa kurrfarë krenarie, as egoizmi folklorik vetëm sa cekë ne mënyre tangenciale faktin historik që gjyshi i tij Mëhill Kola u dallua si trim i veçantë edhe në luftën e Qafës së Agrit në vitin 1910 kundër taborëve të gjeneralit gjakatar turk Shefqet Turgut Pasha. Shtëpia e te parëve

të Ndrekes prej shtatë faqe robsh ka qenë nga me mëdhatë e më të pasurat e Shoshit, punishte bulmeti me (dhi, dele, lope, mushq bletë), tokë, livadhe, hamalla etj. Stili i të rrëfyerit është i qartë, pa stërholime dhe shumë modest, nuk bën krahasime me askënd, ndaj duket sikur skuqet edhe kur tregon fakte të pa kontestueshme për te parët e vet. Ndërsa krejt i shpenguar në mënyre shumë elegante na rrëfen një ndodhi interesante se si humbi njëra nga tre mushkat, kuqalashja atashit te tij moçëm Kolë Nikë Martini si dhe peripecinë e gjetjes pas tre vitesh në pazare të Gjakovës. Kur tata Kole e pa e i thirri: -"kuqo, kuqooo!.., Mushka çoi kryet-përpyjetë, dhe u turr drejt te zoti i vjetër! Autori ka lindur natën e Shën Mëhillit (28 shtator) te vitit 1935, babai i tij mbante emrin e këtij shenjtori i cili për konçidece u flijua tragjikisht pikërisht natën e Shen Mhillit te vitit 1946 pasi kishte bërë qirinjtë dhe prerë qëngjin e festës. "Ma e dhimbshmja ngjarje" kështu titullohet kapitulli më dramatik dhe drithërues i librit ku autori përmallshëm e pikëlueshëm derdh lot e lëshon një lule kujtimi për babanë e tij të dashur dhe dy shokët e tij martir Vogël Kola i Palajve të Shoshit, Tomë Zef Baraktari i Shllakut. Pushkatimi i Dede Mehilit u bë faqe populit të Shalës, Shoshit dhe ne sy të vëllait Luleci dhe kusherinjve te vet nga Brashta. Autori ka shprehur gjithë talentin e tij duke pikturuar një tablo të gjallë që na kujton gjatë gjatë të Parisit. Ndjenja artistike e rrëfimitarit, fiton mbi ndjenjën e thelle të urrejtjes të atij djaloshi të vogël qe të nesërmen pa aguar dita shkon e gjen të masakruar çnjerëzisht babën e vet që ruhej me roje duke mos lenë as kënd të afrohej. Po të kishte fituar ndjenja e urrejtjes mbi ndjenjën e përshkrimit nuk do kisha si t'i referoheja atij tregimi të denje për një tragjedi eskiljane. **Rruga vazhdueke neper Bob e Vuksanajt të Shalës, ku na zgjati derisa zbardhi drita tue iu afrue Urës ré e kur mbërritëm aty ku kishte ndëjë Axha Lulec me shokë, ata na dolën përpara tue na thanë: "Zoti u forcoftë e ju kjo fshi jetëgjatë!,, Mbas pak kohe, un' kërkova me shkue aty ku ishte i vdekun baba i jëm, por ata m' thanë se nuk të lejojnë ushtarët që janë tue ruejtë. Po un' prap ngula këmbë me shkue dhe ashtu veprava: u lshova turr sikur Lepuri që ikë nga friga e Shqyptes! E kur u afrova pranë tij e kujtova se Qiella po u permbyste me ra maje meje: "Ooo Zot... pse... pse?,,**

**Ushtarët nuk më bërtitën! At'herë un' rashë përmbys mbi babën tem, i mbyntun në lot, por pa bërtitë me za. U çova n' këmbë tuj fshë lotët me të dyja duert, e prap kur ia pava gjakun që i kishte dalë prej goje vija-vija, dhe i kishte kalue neper qafë... buzët i kishte si n'gaz e pak të çiluna... po edhe dhambët i kishte të mbyllun e shterngue përjetësisht: po ashtu edhe gjaku i kje ngri mbi krahnorin e tij e bënë një cope, sikur ngrihet akulli n' ortigje pergiatë dimnave të acartë!** Tragjedia vijon me një skenë tjetër rrënoqethëse ndoshta të pa përsëritshme kur Ndreka i vogël i del përpara komandantit

të operacionit duke ju drejtuar- "**Shoku komandant... a ka mundsi me ma lejue trupin e babës per ta vorrosë?,, Por ai prej maje kalit ma vuni dorën e tij mbi krye tuj m' thanë: "a do t'bahesh çun i mirë ti apo jo?,,** Më tepër se prekur i



befasuar nga guximi i djaloshit, komandanti gjakpirës beri xhestikulacion "favorizues" duke ia lejuar babanë djaloshit sygacë të varrosej vetëm jo në mënyre kolektive si dy shokët e tij mbytur në një bunar gjaku. Nuk ka se si të përshkruhet më mire akti i fundit i tragjedisë, skena e varrimit, një riti i pa parë, e i pa dëgjuar në malet e kanunit i posaçëm për "armiqtë" e popullit: Hapja e varrit, ku s' ishte varrosur njeri kurrë më parë, rruajtja e fundit në mes të rrugës nga një guximtar i shkallmuar (Qerim Gjoni, i Lotajve) larja e fytyrës, me uji te ftohte lumi, nxjerrja priqve të varrit, vendosja e një shaklli mëndafshi nga vajza madhe Groshja dhe mbulimi dheun e qullët nga gjaku rrëze djerrit, 3 ore larg varrezave. Pastaj vjen epilogu, gjama në Rreth të Brashtës dhe vajtimi brilant nga bashkëshortja Drande Gjeshja, një ndër vajtoret ma të mirënjohura të Dukagjinit, e cila qau me fjalë burrin e saj të ndjere 53 vjeçar – pa trupin e tij prezent ndër sy të njëmbëdhjetë jetimave, të nenës së tij plakë 83 vjeçe, nder sy të dy vëllezërve, motrave, bijave, kushërinjve, miqve, kumbarëve, dhe krejt dashamirëve tjerë!

I lindur si zog i lirë në viset ku burojnë të dëlira virtytet më fisme dhe rudimentet më thëngjillta arbërore, Ndreke Guri luftoi me guxim duke sfiduar kushtet e mbijetesë. Jeta e detyroi te mësonte zanatin buqtarit, prashitësit, kostarit, barrëtarit, shtegtarit, muratorit, sharruarit, marangozit, karpentierit, druvarit, elektrikist në kategorinë më të lartë. Ndreke Dede Guri pati një imunitet të lindur që rezistoi gjatë, në vapë, acare e stuhi. Nga ky syth i fjetur pas shumë viteve do të shpërthente, sharmi i një poeti popullor të ndjeshëm, të përvuajtur, duke përvetësuar zejen e shkrimit në variantin e Gegnishtes së mbetur si peshku në zalle. Libri është shkruar në vetën e parë, është i ngjeshur me tharmë tipike shqiptare dhe i mëlmyer me mazën

e kulluar te ligjërimin ma pikant dukagjinas. Autori është i ndjeshëm, origjinal i çiltër, si në rrëfim, pa mllefe të njelmëta, krejt i lirshëm në zgjedhjen e fjalëve që burojnë nga tiktaket e zemrës. Përshkrimet e tij janë të gjalla, të freskëta, shumë dramatike, të dhimbshme, në një qiell të zi, të rendur plumb por që zvarritet e kthjellohet ku jeta e rilindë si pranvera pas dimrit me nota optimizmi dhe xixa humori. Rrefimet e Ndrekes me tepër se vlerë letrare, kanë vlerë relative, pasi janë një përmbushje ndjesish, përjetimesh për jetën e tij, të afërmëve, shoqërisë, kundërshtarëve, miqve, armiqve, te mirëve dhe ligjve. Penda e Ndrekes fillon rrëshqet si një busë bore prej "Rrypave te Brejave"<sup>1</sup> qe nuk vonon e bëhet ortek. Penda e Ndrekes shtegton si dallëndyshe në vende të largëta, ngarkuar me hejbe kujtimesh të jetës së kaluar (Brashta, Molla, Shoshi, Shala, Nikaj, Merturi, Pulti, Shllaku, Toplana, Temali, Postriba, Vadejsi, Fierza Komani, Banja, Shkodra, Mirdita Bajram Curi, Lushja, Fieri, Tirana, Detroiti, Miçigami dhe Asutralia në skajn fundor te rruzullit te banueshëm). Pena e Ndrekes fotografon e ringjallë plot pamje e mbresa, ahte, e ehte, flade, e zjarre, fjarde e kënetë, humnera, e zhare, ligësi e vdekje, lindje dhe hare ku ka vozitur misteri 81 viteve te jetës së tij "Episode në vogjëli" është një nga kapituj me tërheqës te librit në të cilin Ndreka ka pasqyruar jo vetëm botën e tij feminare, të pastër, të çiltër, lozonjare të gëzueshme dhe mundimshme. Ky kapitull vjen si një dokumentar i shkurtër etnografik i jetës shpirtërore te Dukagjinit si zakoni i kumbarise dhe prabatinimit, mosha kur vihej pushka në krah dhe përgatitja për mirepërdorimin e saj, festimi i natës së "Shumtëve", "Këshndedhave" dhe festave te tjera që festoheshin me flijime bagëtish ku ne eventit me spektakolar çdo krahine ishte "Partani" festa e fisit. Duke lexuar radhe pas radhe Ndreka na shfaqte nder sy ritin e shkuarjes në festë. I pari rast për autorin ishte shkurja për Shën Gjon të Shalës tek nipi konakut Gjesh Xhuxhi të Vuksanajt. Për here të parë atë dite solemnisht kishte venë pushkën në sup dhe si i barabarte mes të barabartëve mes kumbarëve e dashamirëve si Gjon Marashi, Kolë Micani, Prelë Pepa, Stakë Pjetra kishte "mësy me i ra Shales në derë" Një kujtim i dobishëm për tu evidentuar ishte zakoni tashmë i varrosur i thirrjes nga larg te zotit te shtëpisë nga miqësia: Me 6 shtatorit 1942 Ndreka i vogël na sjellë një piture kujtimesh ku qendër është ai, nena Drande, e baba Dede dhe më pas Kolë Lulash Dema e Dushmanit, Lekë Vojvoda e Balë Marku te Pepsujave të Shoshit, Ndue Kolëa i Mollës Shoshit duke shkuar per Zojë te Merturit. - "**Apo i thrrasim Vatë Çunit!,, E njashtu vepruen, dhe i kanë thirrë tre burra pernjeheri! "Oooooo... more... Vatë Çuni!,, – dy herë rresht. Dhe ai u**

<sup>1</sup> Një vend shume i pjerrët mes bjeshkëve te Brashtës dhe Qytetzës (Pepsujave) ku fillonte shembja e orteqëve te furishëm që bënte rrafshnaltë Lugun e Branikut dhe jehona e te cilave dëgjohej deri te Kisha e Shoshit

# Nga shoqëri vertikale dhune, tashmë jemi në atë “horizontal-vertikale”!

Nga Besi BEKTESHI

Sigurisht që “regjimi ideologjik” nuk do të na linte, as do të na toleronte, të bënim atë çfarë bëjmë sot me njëri tjetrin, ose më qartë, çfarë përdorin sot si një “politikë kulturore” që ka 25 vite që zgjat! Arrogancën dhe agresivitetin individual, të organizuar nga poshtë, të rrugës, të shkollës, të lagjes, nuk e toleronte dhe për më tepër e “sharronte”?! Arrogant dhe agresiv, ishte vetëm ai sipër, kur kishte nevojë të bënte “update” pushtetin represiv të vetin! Ne ishim shoqëri dhune vertikale, por ajo dhunë nuk lejohej horizontalisht! Nuk lejohej, sepse ishte e qartë se ideologjia nuk e lejonte dhe për më tepër regjimi klasik sundues e kishte armike, ngaqë nuk do të mbante dot “duartrokitjet” nga pjesa poshtë për qetësinë dhe rendin! Nuk flisje dot me zë të lartë, nuk ndryshoje dot tonalitetin e zërit, sepse dikush ose shumë kush të thoshte - heej mos bërtit kaq shumë! Pra shëëëët, ulët, pa të bërtitura”. Zërin do ta çosh kur të brohorasësh për partinë dhe shokun Enver, jo në raste të tjera! Dakord! Imagjinoni për arroganca dhe agresivite të tjera rruge, marrje gjaku, vrasje dhe përdhunime, grabitje dhe kërcënime, se çfarë të gjente! Për nxënës që shajnë mësuesin ose e rrahin, për mësues që nuk japin mësim, ose janë arrogantë, për zhurma dhe horra në shkollë dhe në institucione që demonstronin agresivitet dhe arrogancë personale të njerëzve brenda tyre! Po po, ishim në diktaturë të ideologjisë dhe nuk kishim të drejta! Na kontrollonte ajo! Një polic shpesh herë i dalë boje në veshje mbante “suus” gjysmën e stadiumit e jo më, të kishte rrahje dhe shkatërrim masiv të tij! I

gjithë ky agresivitet i sotëm ku pothuaj të gjitha kanë barkun plot, atëhere ishte një qetësi shembullore “me disi dhe shumësi barkun bosh”?! Po po, mbase dhe nga që ishim lodhur, duke realizuar normat në industri dhe bujqësi, sepse na kishte rënë pika deri sa mbaronte tetë orarëshi! Sepse “arroganti i vetëm sipër nesh” na detyronte të shkonim në punë, me turne, në aksion dhe shkollë mbase! Pastaj dhe në kurs pikturë dhe valleje, në sport dhe në aktivitete të shumta jashtë shkollorë dhe jashtë punës! Ec e mos shko po deshe! Të shtunën dilnim dhe pastronim lagjen dhe të hënën në zbor! Të dielën në aksion në fshat, për të hapur kanale kulluese! Pastaj në rradhë të qumështit në mëngjes dy orë, pastaj në rradhë të bukës, sepse mbaronte! Kishte dhe mbledhje fronti dhe lagjeje! Kishte dhe mbledhje kolektivi dhe lexim gazete! Kishte analizë në sport dhe në kulturë ose art! Kishte dhe një uniformë si veshje dhe një lloj filxhani kafeje në klub, ose “ushqimi social”?! Dy lloje biçikletash dhe nga fundi vetëm një, ose ajo e markës “Tirana”?! Tre lloje basmash dhe një doku! Po për çfarë do bënim arrogantin ne, ose agresivin! Me cilin, Enveerin? Me partinë?! Jo, ne nuk jemi nga kjo lloj specie njerëzore! Ne si shoqëri, arrogantit ideologjik i (kemi thënë) themi “bravo” dhe e duartrokasim deri sa na bëhen pëllëmbët fluska”? Po po, më keq se sa me lopatën dhe kazmën që na kishte siguruar ai! Shoqëria jonë të bënte arrogante dhe agresive me ideologjinë dhe diktaturën!? Në asnjë mënyrë dhe asnjëherë! “Suus” dhe urtë fare! Kush bënte gabimin dhe dilte ashtu kot, pa dashje nga “kori, apo hapi rreshtor i përbashkët” shkante për dhjamë qeni menjëherë! Nuk iknim dot jashtë, sepse ideologjia

dhe Enveri kishin menduar të rrimë këtu, urtë dhe pa fjalë! Ju kishte dhënë pushkë dhe zonave të kufirit kryesisht për të qëlluar në shpinë kush ikën, se sa në gjoks, kush vjen nga kufiri?! Dakord? Por dhe nëqoftëse dikush nuk është dakord, unë jam aq “arrogant” sa të them punë e madhe, për diçka që ka ndodhur kështu dhe do të ndodhte dhe 100 vite të tjera, nëqoftëse nuk do të kishte rënë Muri Berlinit dhe kishte ndërruar “erën” Gorbaçovi! Agresiviteti te ne dhe arroganca ishte vetëm vertikale! E ne i jemi përkulur, dhe qëndruar fare urtë!

Sot në saj të njerëzve “të mëdhenj” (kupto palaço) të demokracisë në Shqipëri; atyre që kanë pothuaj tre dekada që drejtojnë këtë vend, ka nisur dhe vazhdon transformimi shoqëror, po sërish me elementin dhunë. Ne vazhdojmë të jemi shoqëri dhune e korruptuar, por me ndryshim nga diktatura, sepse dhune nuk është vetëm vertikalisht, por dhe horizontalisht! Në saj të korifenjve të “demokracisë” që nga Berisha dhe deri më sot në drejtim, liria u shpjegua si dhunë ndaj njëri tjetrit! Si shkatërrim i mirësjelljes, rregullave urbane dhe mos zbatim ligji! Arroganca e politikës, e shoqërisë së politizuar tashmë deri në qelizë, është akoma dhe më vrastare dhe më e pa shpirt se ajo e dikurshme! Në të dikurshmen vrau vertikalisht 4500 veta, kurse në “demokraci” horizontalja ka vrarë 20.000 njerëz dhe vertikalisht ka vrarë brenda një dite 26 veta fare kot dhe në ’97-tën shumë e shumë të tjerë! Në shoqërinë e politizuar në ndryshim nga ajo e ideologjizuar veprojnë dy vektorë të arrogancës dhe agresivitetit, sepse janë si vertikal dhe horizontal! Një njeri normal, qytetar në shoqërinë e tillë, është absolutisht në çdo sekondë i dhunuar ashpër

dhe pa rrugëdalje! Arrogant dhe agresiv një në timon, pastaj një në televizor, një në kuvendin e famshëm të popullit, një në institucion shteti, një në makinë luksi, një në biznes, një në mal dhe tjetri në fushë, dhe çdo sekondë e jetës tënde është ferr që nuk ka nevojë të futesh nën tokë për ta “shijuar”?! Tashmë “demokracia jonë” ka arrogancën dhe agresivitetin si parime ku mbështet shoqëria jonë postdiktaturës! Vajza arrogante dhe agresive “akoma më shumë” se djemtë! Gra më shumë se sa burrat - ose në garë me to! Shoqëria është në kolaps nga arroganca dhe agresiviteti i jashtëzakonshëm që po jeton sot! Gjërat më të mëdha, më të prodhuara në këtë shoqëri sot janë arroganca dhe agresiviteti!

Sigurisht faj ka ajo vetë! Po në “kualitetin e madh” e të qenit më e vonuara në qytetërim në Europë! Por krim kanë prodhimi politik dhe i politizuar i saj, që është njeriu politik në pushtet dhe opozitë! Arroganca e tyre është më qorrrja dhe më kriminalja! Agresiviteti i tyre është burim fatkeqësie, për ekonominë dhe demokracinë?!

Të tjerat që dalin, kërcënimet, vrasjet, të shtënat mureve, dyerve, vrasjet për kryesisht para, për fitime, për afera, për jetë të përbashkët me krimin, janë dhe “fitoret” e mëdha të një klase politike e cila vetëm kështu mund të sundojë një shoqëri injorante dhe frikacake, jashtë çdo “menu-je” që ka të bëjë me kontinentin European! E ka kështu që me krijimin e shtetit shqiptar!

Mbas 27 viteve të vetëpërmbyesjes të diktaturës në Shqipëri, shoqëria jonë është kthyer plotësisht në një “shoqëri e dhunës horizontal - vertikale”?! Pse? Sepse pikërisht diktatura është vetëpërmbyesur dhe aspak e rrezuar nga ndërgjegjja dhe veprimi revolucionar përparimtar i shoqërisë!

◀ **ka pergjegjë: “Oooou... ç’thue moreee!”, “Oooou... po të thotë Ded Mhilli mbrëmja e mirë” dhe pastaj pereshendetej me te shtëna armesh nga te dyja palet**

Mbresëlënëse është dasma e axhes Lulec që mori për nuse vajzën e Zef Bales se Pjollave të Shalës në mesin miqve e shumë të ftuarve at’ natë në dasmë, ishin pesë bajraktarë: **Lulash Gjeloshi i Shoshit, Kolë Ndou i Shalës, Sokol Delija i Nikajve, Tunxh Myftari i Merturit, dhe Pjetër Bala i Toplanës.**

Autori ka vendosur të ndajë shume gjëra me lexuesin në një kohështirje prej tetë dekadash, duke u ndalë në episodet më të qenësishme të jetës, të cilat na i sjellin të kthjellta si lodja. Libri ngjason me një telenovele realiste ku seri pas serie behet me interesante prandaj edhe ai kapitull pas kapitulli lexohet me ëndje. Si episode shume emocionuese veçojmë gjuajtje të çobanëve të Mollës nga një gjakësor në gryke te Kol Nikës ku për fat nuk pati viktima, i strehimit në një Shpelle Brashte kundruell krejt Shoshit në nëntor 1944 ku erdhën brigadat partizane, arrestimi tre javorë e nënës së dashur te cilën Nderka e adhuron si Perëndeshë, si dhe sekuestrimi i gjërave te kushëritit te nënës armikut te

popullit Pjetër Mehmet Shpendi. Episodi i lindjes se vëllait Lini dhe pushkët e gëzueshme miqve të bukës Leke Vojvoda e Mehili Nika e pastaj gjithë Brashtes. ‘Mos harroni o rini vuajtjet e parëve’ thërret ndodhia e mundimshëm kur Nderka 18 vjeçar së bashku me axhën Lulec, e vajzën e axhës tjetër Katrinë Likën, shkuan në Shkodër me shitë kërtolla (patate), dhe me blë misër! **Kemi udhtue 18 ore duke bajtë me shpindë nga 25 kg., un’ dhe 30 kg., ajo dhe Axha Lulec 35 kg dhe po kaq gjate kthimit**. Të rinjtë e sotëm të mpirë dhe topitur nga qëndrimi me orë të tëra para Fb do ishte mire te njiheshin me dashuritë, pengesat, privacionet që ju benë Nderkës i cili nuk i donte gjë tjetër Zotit veç të lejohej te shkante në shkollë, prej së cilës u përjashtua por beri ç’bëri dhe atje ku ishte futur në bri te dhisë e mori maturën dhe kategorinë më të lartë të mjeshtrit. Sa mëkat është sot kur sheh te rinj analfabet dhe viktima te veseve dhe krimet te zi te rrugës, ndërkohë që autori këtij libri shkante ne Salce te Merturit duke kaluar qafen e Agrit në këmbë mes borës. Vrapoi si një Lul i vockël nga “Rethi i Brashtes” në “Kodër Lek Markut” duke përshkruar një rrugë 45 minutshe në zbritje për 7-8 minuta për fituar

me bastin për një “mollë të ndaluar”një laps kopjativ. Ndreke Guri erdhi ne ketë botë për t’i shërbyer të mirës pati në jetë shumë ëndrra dhe ambicje të kushtëzuara nga ky fakt pozitiv. Jeto i në pushtetin e dhunshëm të një regjimi diktatorial, pati fat të shihte duke shëmbur Keopsin e vuajtjeve shqiptare, u ngazëllye duke ëndërrua një demokraci të shëndetshme te cilën e shijoi si qershinë mbi torte por jo ne Shqipëri por ne tokën Amerikane. Ëndrën amerikane e preku e shijoi dhe fort i lumturuar nuk harroi t’i falet nderës Amerikës bujare por mikut dhe dashamirrit ndoshta me të shquar e me të vyer Dom Preke Ndervashajt që ju gjet si vëlla përtej oqeanit. I përmbushur nga jeta, i shëndetshëm, energjik, vital, i pamposhtur nga rudhat, as thinjat e argjendta, të cilat kur nuk ja dolën janë tërheq duke nënshkruar një pakt mossulmimi. Me shtetësi shqiptare dhe amerikane, me shtëpi në Shkodër, Miçigan dhe Velipojë, me një stan në çarranikun e të cilit ka govatat dhe shekat e bulmetit të nxënë nga dora e tij poetike nga rrëfimet jetësore, dorëshkrimet dhe shënimet e përditshme i rrethuar nga vëllezërit, kushërinjtë, mbesat, nipat, miqësia, i respektuar në shoqëri, i mirëqënë si blea

kur mbushë shojet falë dëshirës për punës dhe shëndetit që i dhuroi Zoti. Ndreke Guri tani ne vitin e 81-të të jetës së vet ka vendosur që të lerë ketë testament i cili është -Një jete e rrëfyer në kujtime, të pastra si loti i mallit për babën qe la pa u djersë mustaqesh, te shenjta si gjiri, puthjet dhe dashuria e nënës. Një melodi kujtimesh mirënjohëse për axhat Likun e Lulecin te cilët dy penë ju bene krah duke i kompensuar humbjen e babait, përderisa ai dhe vëllezërit Lini dhe Mehili u bënë tren të shtëpisë së madhe të Mehili Kolës madje duke e çuar akoma me lart. Ky libër vjen si një buqetë trëndafilash të freskët si vetë dashuria e pa moshë për gruan dhe shoqen me të shtrenjtë të jetës. Ky libër vjen si një refren dashurie për jetën e jetuar dhe njerëzit qe e rrethuan qofshin këtu apo në amshim.

Ky libër vjen si një urate ndaj Zotit qe Nderka e falenderon çdo ditë për mirat qe i dha, por edhe lutet me përlësi për mëshirim për çlirimin e botes nga ligësia dhe grykësia e njeriut bishë për njeriun.

**Prele Milani**  
*Poet studios dhe publicist*

# FAMILJA, GJËJA MË E SHTRENJTË

Një grua ishte shumë e sëmur. Ishte vetëm me të shoqin, në moshë të thyer që të dy. Fëmijët i kishin jashtë shtetit me punë të gjithë. Fëmijët merrnin në telefon herë pas here dhe interesoheshin për nënën e tyre. Po të bëhet më keq na merr në telefon urgjent, i thonë të atit. Në një moment, babai i tyre, përgjigjet gjithë nervozitet, “Nuk di, por e sëmur është boll, vdekë nuk kemi ndonjë herë as unë e as ajo, se ça është ka bahet nuk po di”.

Një nga shtyllat më të fuqishme që ka bërë të mundur mbijetesën e popullit tonë ka qenë familja, ruajtja e saj nga shpërbërja, edukimi me traditat më të mira dhe përballimi i jetesës në mënyrën më të mirë të mundshme duke pasur parasysh vendin dhe kohën. Qëndrueshmërinë e familjes e kanë vrojtuar edhe historian, gazetarë, studiues e udhëtarë, të cilët kanë vizituar Shqipërinë. Shembull, nga më të mirët, mund të përmendim krahinën dhe malësorët e Dukagjinit.

cioni shumë të fuqishëm. Është larguar pjesa me jetësore e shoqërisë tonë, rinia, por duket se po vazhdon përsëri, ndonëse jo me atë vullin e fillimit. Është kënaqësi kur shikon ruajtjen dhe vazhdimin e fuqishëm të lidhjeve familjare. Kjo tregon për familje e lidhje të fuqishme, për edukimin tradicional të këtyre lidhjeve që janë bërë ura të fuqishme të traditës tonë të mirë. Shikohen ndërtime të bukur, kudo ku banojnë malësorët tonë, në fshat e qytet, por, ndërtimet po marrin rrugë edhe në vendlindje tonë, në Dukagjin. Të gjitha këto ndërtime, ose të paktën shumica dërmuese e tyre janë bërë dhe po bëhen me investimin e mundit dhe djersës së emigrantëve që morën rrugët e botës në mënyrën të vështirë, dhe të rrezikshme. Por kush qëndron brenda tyre? Nuk po them të gjitha por në shumicën e tyre gjenden një plak e një plakë, prind të emigrantëve, ose një çelës në derë, apo një kujdestarë si roje. Po, kështu erdhi jeta.

e tyre të sëmurë, me dashuri të madhe, me respekt, pa çka se ajo e kishte hëngër livadhin e vet. Madje djali i vogël i saj, tash i martuar dhe i bërë baba, për javë e muaj fle në një dhomë me nënën e tij, sepse kishte dëshirë që ti ishte pranë saj në çdo moment. Nipi apo mbesa i duan gjyshërit sipas mëkimit që u bëjnë prindërit e tyre.

Prindi, veçanërisht kur i afrohet fundi ka nevojë njerëzore ti shohë fëmijët në radhë të parë, nipat, mbesat, rejat, etj. Ata sikur ja largojnë dhimbjen, edhe kur është pa kthim, i krijojnë kënaqësi, ndjehet mirë e rrethuar me dashurinë e tyre. Ai dëshiron ti shohë kur mund të flasë, ti shikojë, të ndjejë dorën e tyre mbi balle, të dëgjojë zërin e tyre, mbase të lerë edhe ndonjë porosi apo dëshirë të fundit.

Por si edhe në të tjera raste, edhe këtu ka përjashtime. Nuk kanë thënë kot prej kohësh “rrugët e botës ti lëvdofshin e mos i provofshim” por kohët kanë ndry-

e besim të punëdhënësi për tu gjendur në ditë të vështira të njerëzimit të tu. Është e rëndësishme të jesh në përcjelljen për në banesën e fundit prindin apo të afërmin, por domosdoshmëri e pa zëvendësueshme është takimi për së gjalli me të. Mund dhe duhet të priten e përcillen pjesëmarrësit bujarisht, sepse kanë treguar respekt me ardhjen e tyre, mund të derdhen shume lot e qahet halli, por çfarë duhen këto e të tjera kur nuk ja shikove sytë nënës apo babës pa ju mbudhur përgjithmonë, t’ia dëgjosh zërin sado i mekur qoftë, pa ju ndalur përgjithmonë, të ta dëgjojë zërin sado vështirësi të kenë, pa ja puthur faqen pa ju ftohur përgjithmonë. “Emigrant” mund të bëhen njerëzit edhe brenda atdheut, madje edhe në plazh, apo në bjeshkë.

Te prindi shkohet sa të jenë gjallë, ndërsa kur të vdesin, bëhen përpjekje për të treguar se kë kanë lanë, tu japin respekt pjesëmarrësve, të respektohen ata, ti



Në këtë krahinë, rreth së cilës po ndalem më shumë, ka pasur familje të mëdha në numër, dhe që kanë jetuar për një kohë të gjatë bashkë, natyrisht mbi bazën e rregullave të përbashkëta familjare dhe shoqërore. Në dallim nga zonat fushore e veçanërisht qytetet, djemtë edhe pas martesës kanë jetuar për një kohë relativisht të gjatë me familjen amë, kjo, për të ndihmuar ekonominë familjare, rritjen e fëmijëve të tjerë, etj. Pa tjetër që do të vinte koha për të krijuar familjen e re e mëvetësinë e saj, por gjithmonë ka pasur dhe ka mbështetjen morale dhe materiale nga familja amë, veçanërisht deri sa ka vu “shqojt” e vet. Çdo familje e re do të merrte pjesën që i takonte sipas rregullave të përgjithshme shoqërore të kohës. Tradita e lidhjeve dhe marrëdhënieve familjare ka ardhur deri në ditët tona dhe uroj që të vazhdojë gjatë edhe në të ardhmen duke u zhvilluar e përparuar, pavarësisht se ruli i globalizimit po vepron fuqishëm në njëjtësimin e kulturave e zhvillimit në tërësi. Po bëhen tri dekada i një emigra-

Mirë që prindërit qëndrojnë në këto shtëpi, në këtë vend që e duan shumë dhe kanë përtesë për tu larguar, veçanërisht sa të kenë mundësi për ti shërbyer vetes, por koha kalon, vitet shtohen mbi shpinën e prindërve, plus edhe ndonjë sëmundje që rëndon shëndetin e tyre. Këto janë të natyrshme e nuk ka gjë për të çuditë. Do të vinë dita edhe për të ndërruar jetë, dhe prindi shkon zemër plot kur len prapa fëmijët dhe familjen e tij të mirë.

Prindi nuk ka vetëm detyrën që të lind fëmijën. Ai duhet ti japë përvojën e tij dhe të përpiqet ta edukojë, por edhe fëmija duhet të përpiqet që të kuptojë prindin, të dëgjojë dhe përvetësojnë përvojën ta takojë me të renë që fëmija ka takuar në jetën e përditshme dhe të gjejë rrugën me të mirë. Edhe kjo nuk është e lehtë për tu realizuar, kërkon mjaft kujdes e vullnet.

Në një familje komshi, gruaja më e vjetër në atë familje ishte shumë e sëmur. Ishte shumë kënaqësi, kur shikojë djem e vajza, nipa e mbesa, stërnipa e stërmbesa, që rrethonin nënën, gjyshen e stërgjyshen

shuar dhe ne duhet ta pranojmë. Ato të përfshinë në rrjedhën e tyre, të çojnë larg, shumë larg, në kombe e fise të ndryshme. Ata kanë tjetër ndjesi familjare nga ne, kane ndjesi ndryshe nga ne, për ndarjen nga jeta të prindërve, familjarëve apo të afërmeve, sepse çdo popull ka natyrën, gjuhën, kulturën, lidhjet familjare të ndryshme nga të tjerët.

Puna për emigrantët është domosdoshmëri, sepse për të punuar janë atje, por kur është fjala për prindërit, familjarëve, të afërmeve, ata kanë treguar shumë kujdes. Kanë qenë të pranishëm në momente të vështira të jetës së tyre, kanë marrë përsipër punë dhe kanë ndihmuar fuqishëm. Zhvillimi ka shumë rëndësi të pranohet e përqafohet, por çdo gjë me kandar, as me vrap as ngadalë, por prania pranë prindërve apo edhe të afërmeve në momentet e fundit të jetës është një bekim i paçmuar për të dy palët. E di se ndokush mund të thonë “po janë në punë” etj. Po, po, në punë janë por me punë është e mundur që ti krijosh vetes atë respekt

falënderosh për respektin që po u bëjnë, madje shpesh kërkohet edhe ngritje gotash “për shpirtin e të vdekurit” që iku nga kjo botë.

Si në çdo gjë edhe në këtë rast ka përjashtimet e veta, siç është rasti i mos mundësisë për takimin e fundit, para vdekjes, kur familjari është i sëmurë në shtrat apo i ndalur nga forcat ligjzbatuese, në raste të tjera nuk është fort e arsyeshme mungesa.

Unë po e mbydhë këtë shkrim me disa vargje të një poezia të shkrimtarit të madh Dritëro Agolli:

“... Tek nëna s'vinte sa ish gjallë,  
Mbase vinte, por besoj, se shumë radhë,  
Erdhi kur e shpuri në varreza,  
Sypërlotur, veshur me të zeza,  
Ah, tek nëna s'vinte sa ish gjallë,  
Dhe tani në varr i shkon çdo javë,  
Një mëkat që ndofta s'lahet kurrë,  
Shkon e lan, ku nëna fle në gurë”.

Luigj SHYTI

# ZOJË LOJZI - BIJA E THETHIT, GRUAJA E GIMAJVE, NJË BIJË, NËNË DHE BASHKËSHORTE SHEMBULLORE

Para disa ditësh vdiq një zonjë, bijë e Thethit, grua e Gimajve, qytetare në kuptimin e vërtetë të fjalës, gjysmë shekullore në qytetin Shkodër, me emrin Zojë. Ajo ishte bija e Gjergj Micanit të Thethit, bashkëshortja e Ndue Gjini Lojzit, nënë shumë e dashur për djalin e vetëm Paulinin dhe e dy vajzave të saj Vitore dhe Margarita. Vdekja i erdhi nga një goditje cerebrale, por vdiq si një sokoleshë, si një grua fisnike, si një qytetare e denjë, si një nënë, si një gjyshe, si një vlerë jo vetëm për familjen e njerëzit e saj, por edhe për një rreth të gjerë miqësh dhe dashamirësh farë e fisi e qytetarësh, të cilët e përcollën me shumë respekt e dhimbshuri për në banesën e fundit.

Radhë herë është parë një përcjellje e tillë, dhjetëra e qindara njerëz nga Thethi, nga Gimajt, nga Bajza, Golemi, Bërdica, nga bashkë krahinarë e bashkëqytetarë. Një moment i veçantë hijeshije e bukurie e mbuloi arkivolin e saj me të cilën të dukej se ajo, me dashuri, po i falënderonte njerëzit për atë përcjellje madhështore që po "banin".

Përse ndodhte gjithë kjo dhimbshuri, gjithë ky respekt, kjo dashuri për një grua rreth të tetëdhjetave?

Jeta i është dhënë njeriut për ta jetuar, për ta gëzuar, për të dhënë e për të marrë prej saj, prandaj është e dashur deri në fund. Shkrimtari ynë I madh Dritëro Agolli në ditët e fundit të jetës së tij shprehu dhimbje sepse "nuk I kam thënë të gjitha çfarë kisha për të thënë", prandaj e donte jetën.

Edhe Zoja e donte jetën, sepse i donte njerëzit, secili kishte vendin e vet në zemrën e saj dhe secili merrte prej saj buzëqeshje, mirënjohje, respekt e dashuri. Këto cilësi të larta njerëzore i kishte dhunti. Gjithë jetën e saj na dhuroi këtë dhunti, jo vetëm njerëzve të saj atje ku u lind dhe u rrit, atje ku u bë nuse, atje ku u martua, atje kudo që punoj si punonjëse shembullore e tregtisë në fshat e qytet.

Po si i kuptoj dhe i zgjidhi ajo problemet që ishin dhe janë prezent edhe në ditët e sotme, familjare si bijë, si nuse, si vjehërr, si bashkëshorte, dhe si nënë? Mendoj se ia vlen të bëjmë të njohura disa aspekte të jetës së saj, për të zbuluar vlerat e kësaj gruaje. Ajo u lind në një truall me vlera fisnike, me burra e gra në za dhe të pashëm, tradita të spikatura që i karakterizuan malësorët tonë, si ndera, burrëria, bujaria,

mikpritja, bukëdhënia për të njohur dhe të pa njohur, etj. Por Zoja, që në moshë fare të re, mbeti jetime sepse i vdiq nëna. Zoja provoi dhimbje e trishtim që sado u përpoq baba i saj nëna i mungonte. Një shkrimtar italian thotë: "Zoti nuk mund të ndodhet kudo, prandaj ka krijuar nënën". Plaga e shpirtit të saj u mjekua dalëngadalë nga njerka e saj, Katrinë Lulja, e cila e deshi shumë, ashtu si djalin e dhe vajzën e saj që solli me vete nga martesja e parë. Këtë dashuri, e këtë përkujdesje ajo e ka vlerësuar shumë tërë jetën, prandaj njerken e quajtur "nënë" gjithë jetën e saj.

Zoja u martua në Gimaj, në një familje në za dhe me tradita, ndër e burrëri, në Shtëpinë e Gjini Sokolit. Nuk po ndalemi në marrëdhëniet bashkëshortore prej të cilave lindën një djalë e dy vajza, po kaloj shkurt te marrëdhëniet e saj me vjehërrinë, problem aktual për çdo familje edhe në ditët e sotme. Ajo udhëhiqej nga urtësia popullore se po deshe burrin duhet të duash edhe nënën e burrit që ka lindur "sokol për ty", por edhe babën e tij. Këtë e realizoi, Zoja, duke fituar dashurinë dhe respektin e tyre, të cilët nuk u ndanë asnjëherë, as në fshat dhe bashkë erdhën edhe në qytet. Puna që bënte Zoja në tregti merrte shumë kohë, por asaj asnjë herë nuk i mungoi kujdesi e shërbimi ndaj tyre, sidomos kur vjehërra e saj zuri shtratit në pleqërinë e saj për dhjetë vjet rresht, duke ia lehtësuar dhimbjet, po ashtu edhe vjehërrit për shumë kohë, i cili e vlerësonte shumë renë e tij, dhe herë pas here e uratonte "ta priftë zoti mbarë për çka ke ba për mua".

Zoja kur u martua gjeti në familjen e burrit gjashtë kunata, vetëm njëra ishte e martuar, me të cilat ndërtoi marrëdhënie shumë të mira, aq sa, ato, edhe kur i kishin prindërit në shtëpinë e vëllait, kurdoherë gjenin nusen e vëllait (kunatën e tyre) të gëzuar, të qeshur, të dashur, kudo herë derë dhe zemër të hapur, e kjo jo vetëm ato por edhe burrat dhe fëmijët e tyre. Ngrohtësinë e Zojës ato ve vlerësonin shumë sa edhe fëmijët e tyre e thirrnin "nanë", ashtu si fëmijët e saj, mbi njëzet nipa e mbesa të asaj shtëpie. Nga këto, kuna-

ta, e ndoqën me dhimbje sëmundjen e saj në spital dhe në shtëpi dhe derdhën shumë lot për vdekjen e saj. A nuk është ky shembull kuptim plot se si duhen nderuar dhe respektuar njerëzit e burrit dhe si fitohet dashuria dhe re-



spekti i tyre. Zoja pati një djalë dhe dy vajza. Shembull për ta u bë nënë e tyre, e cila si çdo nënë krijesat e saj i donte shumë, por ajo kishte një përkushtim të veçantë për formimin e tyre, mësimin, edukatën, e mirësjelljen e tyre. E gjente kohen te merrej me gjithçka. Ajo ishte shumë kërkuese ndaj tyre dhe shumë korrekte me shembullin e saj. Zoja ishte autoritare, nuk bërtiste, nuk shante, nuk mallkonte, megjithatë fjala e saj ishte e fortë, bindëse.

Duke e ditur rolin e nënës, jo vetëm si ripërtëritje e jetës, por më e rëndësishmja dhe më e vështira dhe më vlerësues për edukimin e rritjen e shëndetshme të fëmijëve të saj, mund të themi se në këtë drejtim ka dhënë një shembull shumë pozitiv. Fëmijët e saj u rritën, u edukuan, u shkolluan dhe u përgatitën për jetën si qytetarë të dëgjë, me moral të lartë e sjellje shembullore. Ata, tani, janë të lumtur me familjet e tyre, në harmoni, të gëzuar

për jetën e fëmijët e tyre. Paulini ka vite që jeton në Kanada, ka biznesin e vet, është bërë edhe gjysh atje. Rruga e gjatë, e lodhshme dhe me kosto, nuk e penguan atë që të vinë edhe dy herë në vit te prindërit e tij, duke u krijuar

të gjitha kushtet e jetesës. Ai erdhi kur ajo u sëmurë rëndë për tu çmallur me nënën e tij të dashur. Agoninë ajo e shtyri deri sa erdhi Paulini nga Kanadaja, për të parë dhe për të bashkëbiseduar me nënën e tij, duke i lënë edhe amanetet e saj, për familjen e tij, për bashkëshortin e saj, motrat e gjithë njerëzit e tyre të dashur. Për 72 ditë, aq sa zgjati sëmundja, ajo u ndodh e rrethuar nga dhimbja, dashuria e shërbimi i plotë, duke bërë gjithçka të mundur për shërimin e saj, nga dy vajzat, Vitorja e Margarita, natë e ditë, në spital dhe në shtëpi. Ato, me përkushtimin e tyre, treguan forca, karakter, sakrificë, bënë gjithçka për nënën e tyre që ta mbanin në jetë, ashtu siç po bëjnë gjithçka edhe për babën e tyre që të përballojnë edhe humbjen që pësuan me vdekjen e Zojës. Aty, pranë saj, çdo ditë dhe në momentin e fundit u gjend edhe motra e Zojës, Shaqe, e cila e deshi shumë dhe në çastin e fundit ia mbydhë me lot sytë e saj. Kunatat gjithashtu, çdo ditë

me lot po përcjellin dhimbjen e tyre të thellë. Nuk mund të mos theksoj, ose të veçoj, kujdesin e jashtëzakonshëm të djalit të axhës së saj Pal Frani, i cili nuk u shkëput asnjë ditë prej saj.

Po e mbydhë këtë shkrim me pak vargje të një poeti të ri, i cili jeton në emigracion, i cili si gjithë të tjerët, ata që i kanë prindërit e tyre "zhuriten" nga dashuri e malli për njerëzit e tyre, e sidomos për nënën:

Është pak këngë pa fund me këndue,  
Është pak vargje pa fund me shkru  
Është pak me thur hymne pa ia da,  
Është krejt pak me ia falë zemrën,  
asaj që të ka ba.

Një nënë e tillë si Zoja e meriton plotësisht këtë vlerësim, prandaj ajo u bë e mbeti e shëjtë për familjen e të afërmit e saj, e dashur dhe e paharruar për të gjithë ata me të cilët punoi e jetoi.

**NDOC GRIMAJ**

# SIMBOLI I KULTURËS ZADRIMORE QË NA MUNGON...

Ndahet nga jeta në moshën 61 vjeçare Terezina Shtjefni (Correj)

Në datë 10 Gusht 2018, mbylli sytë përgjithmonë, një ndër simbolet më të pikante të folklorit zadrimer (dhe jo vetëm), Terezina Shtjefni.

E lindur në 12 Qershor 1957 në Gur të Zi, ajo do të shquhej si përçuese e denjë e kulturës zadrimore, të trashëguar që në genin familjar. Mbaron shkollën e muzikës në Shkodër dhe emërohet mësuese muzike në shkollat e ndryshme të zonës, ku dallohet jo vetëm për përkushtimin në realizimin e detyrës fisnike të mësimdhënies, por veçanërisht në gjurmimin dhe hulumtimin e traditave të bukura të Zadrimesë.

Fati i jetës e lidhi me një familje të spikatur për lëvrimin e kulturës dhe traditave të këngës popullore e folklorike, familjen "Shtjefni", me të cilën kompletohen dhe zhvillohen më tej vlerat unike të ruajtjes dhe përcjelljes tek brezat të thesarit folklorik të Zonës së Zadrimesë.

Është ndër rastet unike që një artiste të jetë pjesëmarrëse për afro 30 vite rresht në Festalet Folklorike, e inkudruar si pjesë e Rrethit (Qarkut) Shkodër pa shkëputje.

Në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës 1988 paraqitet me shumë sukses me motivin "Ra hana" dhe me një këngë të kënduar në kuartet, me tekst të përshtatur, në trio së bashku me interpretueset e talentuara, Luçe Gjoni (Haxhari) dhe File Ndreca.

Në Festivalin Folklorik të Beratit 1995, sërisht ky formacion dhe Roza Ndoci 73 vjeçe merr pjesë me 3 motive zadrimore, "Këngë e naltë", "Moj Syzezë vetullkuronë" dhe "Ç'asht kjo xixë që xixillon".

Në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës 2000 merr pjesë me 2 motive zadrimore: "Këngë majëkrah" dhe "Broj-Broj" shoqëruar me fyell nga Ejll Gjoni, ku interpretuese janë Terezina Shtjefni, Loreta Hila, Luiza Simoni nga Guri Zi.

Në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës 2004, drejton komplet grupin përfaqësues të Gurit të Zi ku prezantohet me 5 motive: "Këngë vaji", "Balli yt o moj e ngratë", "Fëllanca", "Moj nuse me kë m'ke ardhë" (kënduar në kuartet) dhe "Po kcen lepri bisht më bisht" më solist Klaudio Rrokun. Interpretuesit janë 5 burra, 6 vajza dhe një fëmijë – Guri Zi.

Terezina shquhej për kualitetin e punës dhe seriozitetin me të cilin përgatiste programet. Kujtoj një rast kur në Fshatin e Paqes, zhvillohej konkurrimi për vlerësimin e numrave përfaqësues të Qarkut Shkodër, në Festivalin Folklorik. Secili grup përfaqësues kishte 20 minuta kohë për prezantim. Pavarësisht kësaj pothuaj të gjitha grupet prezantuan për më shumë se 30-40 minuta programin, përveç Gurit të Zi, nën drejtimin e Terezina Shtjefnit që prezanton 5 numra folklorik në 17 minuta. Komisioni i ekspertëve vlerëson fitues të pesë numrat e Gurit të Zi ndërkohë që

nga grupet tjera selektohen një, maksimumi dy numra.

Si mësuese e talentuar e edukimit muzikor, duke qenë pikësynimi kryesor përgatitja e elementit të ri dhe edukimit të tyre me dashurinë për kulturën dhe artin, ajo pati një përvojë tepër të suksesshme në punën me fëmijët.

Aktivitetet më të rëndësishme në këtë kuadër janë:



- Pjesëmarrja në Manifestimin e Inaugurimit të "Këmbanës së Paqes" pranë QNK në Tiranë, Dhjetor 1999 – Kënga Këmbana e Paqes (e krijuar me mjeshtëri nga Paulin Shtjefni).

- Përsëritje me këtë këngë në natën finale të Festivalit të Këngës në RTV, Dhjetor 1999.

- Pjesëmarrja në Festivalin Kombëtar të Lojërave Popullore në Durrës në vitin 2000, 2001 dhe 2002, ku është nderuar me diploma të veçanta, duke përfaqësuar Qarkun Shkodër.

- Pjesëmarrja në tre festalet rajonale folklorike të organizuar nga Shoqata Kulturorë – Turistike "Sarda" në Ishullin mesjetar të Shurdhahut. Në të tre pjesëmarrjet është vlerësuar me çmime.

- Organizimi i spektaklit "Dita Botërore Kundër Varfërisë" mbështetur nga OXFAM GB, e vetmja e këtij lloji e organizuar në zona rurale.

- Pjesëmarrja në Manifestimin e grupeve më të mira folklorike të Shqipërisë, organizuar nga Ministria e Kulturës në Tetor 2015, ku në mes të Tiranës u evokua gjithë tradita e Zadrimesë, që nga punimet e tezgjahut, puna e dorës e deri tek këngët e vallet karakteristike, për të cilët ato morën përgëzimet e veçanta të Ministres së Kulturës, zonjës Kumbaro.

Duke e ndjerë veten përfaqësuese e komunitetit të Gurit të Zi, ajo nuk hezitoi asnjëherë për të bashkëpunuar me Komunitetin e Gurit të Zi dhe për të evidentuar vlerat më të spikatura kulturore – artistike të kësaj treve.

Disa nga aktivitetet më të rëndësishme, rezultat i këtij bashkëpunimi kanë qenë:

- Koncert me motive folklorike dhe këngë popullore shkodrane, gërshetuar me montazh muziko-letrar me titull: "Mirënjohje" duke nderuar disa nga amatorët e kësaj zone në vite, në vitin 2003.

Aktivitet Festiv me rastin e Vitit të Ri 2006 duke ja dedikuar 45 vjetorit të Gru-

pit të Parë Artistik të Zonës, e shoqëruar me foto, kujtime nga vetë amatorët-veteranë dhe janë nderuar me tituj nderi 4 prej tyre.

- Aktivitet në "Ditën Ndërkombëtare të të Moshuarve" me të gjithë pensionistët e zonës, në vitin 2005, në bashkëpunim Komuna Guri Zi dhe Kolping.

- Aktivitete festive me rastin e festave të fundvitit 2000, 2001, 2002, 2003, 2004 dhe 2005 me grupin artistik të shoqatës, me këngë e humor me urimin tradicional: "Pritshim t'mirë mot".

Realizimi i konkursit "Bilbilat e vegjël këndojnë" me fëmijët e zonës (2009).

- Ekspozite me punime aplikative të fëmijëve të zonës (2011).

- Realizimi i projektit "Artizanet e reja të Zadrimesë" (Maj - Qershor 2014) me mbështetjen e Ministrisë së

Kulturës.

Jo vetëm brenda trevës së Zadrimesë, por edhe jashtë rrethit janë zhvilluar një sërë aktivitetesh kulturore – artistike dhe folklorike, me protagoniste Terezina Shtjefnin. Të tilla mund të përmendim:

- Koncert me këngë e humor në Ulqin – Prill 2004 me grupin artistik të Zadrimesë.

- Pjesëmarrja në Festivalin Folklorik mbarëkombëtar "Oda Dibrane" – Nëntor 2005, duke përfaqësuar rrethin Shkodër (i vetmi grup artistik i veriut të Shqipërisë, përveç mikpritësve).

- Pjesëmarrja e një pjesë të grupit në Festivalin "Oda Dibrane" 2006, si pjesë përbërëse e grupit përfaqësues të Shkodrës.

Edhe stafi artistik i Televizionit Shqiptar, duke njohur dhe vlerësuar kontributet e pazëvendësueshme të Terezina Shtjefnit, gjeti fusha të bashkëpunimit plot sukses të mishëruara në emisionet:

- Kënga Folklorike e zonës – 1999.

- Kënga popullore shkodrane tek brezi i ri, shoqëruar me një bisedë të shkurtër me kompozitorin e shquar shkodran Zef Çoba në studion e RTSH. Këngët janë interpretuar nga grupi i djemve dhe vajzave të shkollës së mesme të përgjithshme Guri Zi – Maj 2004.

- Koncert me këngë e valle folklorike nga grupi i fëmijëve të zonës, në vitin 1999, në studion e RTSH.

- Koncert me motive të ndryshme folklorike për korrijen, valle humoristike, këngë majëkrah, pjesë nga rituali i dasmës, etj, në studion e RTSH në vitin 2001.

- Koncert i gërshetuar me folklor dhe këngë nga Festivali i Fëmijëve në vitin 2002, në studion e RTSH.

Janë zhvilluar edhe aktivitete të tjera të mrekullueshme dhe mbresëlënëse për të gjithë publikun e Qarkut të Shkodrës dhe

më gjërë. Për këtë mjafton të sjellim ndër mënd:

- Manifestim i Folklorit të Qarkut Shkodër – 2002, në bashkëpunim me Qendrën Kulturorë të Fëmijëve Shkodër.

- Manifestim i Lojërave Popullore – viti 2000.

- Përsëritje në dy festivale (36 dhe 37) kombëtare të fëmijëve në Shkodër, në natën finale.

- Pjesëmarrje në dy edicionet e fundit të konkursit "Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë, ku të pesë konkurentët pjesëmarrës të Gurit të Zi janë seleksionuar në 20-shen më të mirë (nga mbi 200 konkures).

- Realizimin e Koncertit Recital të këngëtarit Artur Matija (2011), duke qenë "prapavija" e gjithë koncertit me grupin e saj artistik, nën drejtimin e mjeshtër Osman Mula, falë edhe angazhimit plot eksperiencë, kreativitet dhe përkushtim të talentit Paulin Shtjefni.

Por nëse ka një kulm të aktivitetit të saj artistiko-folklorik, ajo padyshim është realizimi i videoklipit "Ritual i Dasmës Zadrimore" në vitin 2010. Një punë e jashtëzakonshme, që vetëm një talent i lindur, mund t'a realizojë me aq përgjegjësi, të menduar deri në detaje, duke përjetuar sipas një tradite shekullore gjithë etapat e dasmës, që nga "Dita e Leçisë" dy javë përpara dasmës, e deri në marrjen e nuses dhe daljen në valle. Në këtë aktivitet ishin të përfshirë rreth 80 pjesëmarrës të moshave nga 6 në 80 vjeç, të gjithë me kostume kombëtare dhe secili me një rol specifik në këtë ritual. Realizimi i këtij aktiviteti brilant u realizua falë mbështetjes së Ministrisë së Kulturës, ndonëse me një fond modest vetëm 400.000 lekë, kur normalisht kërkohej 10 herë më shumë.

Disa vite radhazi ajo ideoi për 8 Mars aktivitete me nënat e fëmijëve të dalluar, duke u ofruar atyre këngë, valle e recitime të përgatitura me aq mjeshtëri nga ana e saj dhe të interpretuara nga fëmijët.

Në Maj 2006, së bashku me Komunitetin e Gurit të Zi, realizon aktivitetin "Vlerat shpirtërore të një treve" në Hotel "Rozafa" Shkodër, ku shpalosen gjithë resurset natyrore, historike dhe shpirtërore të zonës.

Aktiviteti i fundit i realizuar nga ana e saj ishte para një viti, në kuadrin e aktivitetit të Bashkisë Shkodër "Promovimi i vlerave dhe resurseve të Trashëgimisë kulturorë, natyrore dhe të territorit" në qendër të Njësisë Administrative Guri Zi, ku edhe njëherë u shfaqën vlerat unike të kësaj treve, të mishëruara në pasionin e Terezina Shtjefnit.

Padyshim ajo ishte zëri më i fuqishëm që i kishte mbetur Zadrimesë për evidentimin e potencialeve të jashtëzakonshme që mbart në fushën e artit dhe kulturës.

ALFRED HAXHARI

# Gjergj Kastrioti Skënderbeu, “Mbreti i albanëve dhe epirotëve” dhe Pal Ejlli, “Kardinali i albanëve dhe epirotëve” ...

Agron Luka

*Me rastin e Konkursit për 550 –vjetorin e vdekjes së heroit nacional Gjergj Kastrioti Skënderbeu.*

*Me rastin e 10 –vjetorit të Përgjigjes së autorizuar nga Papa Benedikti XVI, drejtuar “Shoqatës Atdhetare Dukagjini” dhe “Shoqatës Integrimi në Evropë”, në lidhje me materialin studimor mbi titujt e merituar realë, retrospektivë dhe honorifikë, për Gjergj Kastriotin Skënderbeun, “Mbret i Albanëve dhe Epirotëve” dhe për kryepeshkopin Pal Ejlili, “Kardinali i Albanëve dhe Epirotëve”, shkruar nga studiuesi Agron Luka.*

*(Përse Presidenti dhe Presidenca e Republikës së Shqipërisë, Kryetari dhe Institucioni i Kuvendit, Kryeministri dhe Kryeministria, Akademia e Shkencave etj, heshtën si gurë varresh dhe refuzuan një ballafaqim – diskutim argumentesh apo qoftë edhe një verifikim minimal të thjeshtë në vitet 2003 - 2008 - 2012?!)*

Në 14 janar 2003, në lidhje me zërat sensacionale e të ashtuquajturat dokumente me interpretime bllofe, që qarkulluan “mbi shpalljen e Skënderbeut si Mbret”, ne botuan një studim analizues, “A është shpallur ose vetëshpallur Gj. K. Skënderbeu si Mbret në vitin 1458, apo i kishte paraprirë kësaj shpalljeje?!”. (Gaz., “Shqipëria Etnike”, 14 janar 2003, f 12-13)

Në vitin 2007, mbasi kishim botuar me seriale, disa shkrime e studime, ne kishim ardhur në idenë se, ekzistonte mundësia për një njohje honorifike retrospektive, me rastin e 100 – vjetorit të “Ditës së Flamujve, Mëvehtësisë e Vetqeverimit” me 28 nëntor 2012, për këto titullatura, të cilat “de facto” populli mesjetar albanepirot i shek XV ia kishte miratuar dhe i përdorte në gjuhën popullore, fakt ky që vërtetohej në veprat e Marin Barletit dhe diku edhe në ndonjë dokument kohor.

Edhe vetë protagonistin diplomatik i ngarkuar zyrtarisht, i “mëvehtësi – autonomisë nën sovranitetin e suzeranitetin e Sulltanit”, ishte deklaruar në Kujtimet e tija se, “*po ngrinte flamurin e lavdishëm... të sovranit të fundit nacional të Albani – Shqipërisë*”. (“Lufta për Çlirimin kombëtar në vitet 1878 – 1912”, bot. 1962, f 489-490, nxjerrë sipas “The Moirs of Ismail BEY”, London 1920, f 370-373)

E sinqertë apo me hije dyshimi, për formulime hipokrite dhe veprime e marrëveshje të fshehta të tjera praktike për një monarki me një mbret me vazhdimësi turke apo myslimane, këto mbeten të diskutueshme, përderisa flitet se në arkiva ka ende materiale të pa hapura...

Gjithsesi, në përputhje edhe me këto realitete historike, duheshin korrigjuar e rivendosur në originalitetin e tyre edhe heraldikat e simbolet autoktone, natyrisht



NUNTIATURA APOSTOLICA  
IN ALBANIA

N. 7848/07

Tiranë, 14 Nëntor 2007

Nunciatura Apostolike në Tiranë paraqet nderimet e saj të shquara Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” dhe Shoqatës “Integrimi në Evropë” dhe ka nderin të njoftojë marrjen e letërës Nr.470 Prot., datë 05.11.2007.

Nunciatura falenderon për dërgesën dhe kërkon me mirësjellje që materiali t’i dërgohet në gjuhën italiane ose në ndonjë gjuhë tjetër të njohur si dhe të shënohen në mënyrë të qartë dhe të veçuara burimet historike të cilat janë marrë si referim.

Nunciatura Apostolike përfiton nga rasti për t’i shprehur Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” dhe Shoqatës “Integrimi në Evropë” ndjenjat e konsideratës së lartë.

Arqipeshkvi Giovanni Bulaitis  
Nunci Apostolik

Shoqatave “Atdhetare-Dukagjini”  
dhe “Integrimi në Evropë”  
Lagjia Vojo Kushi  
Rruga Çlirimi, P. 1261  
SHKODER

*Përgjigjet e dokumentuara nga Nunciatura Apostolike e Selisë së Shenjtë dhe nga Sekretaria e Shtetit të Vatikanit*



*Gazeta “Drita” e 1936 dhe Buletini 16 nëntor 1944, me të njejtin stil e flamur, kapnin “Plakun e Vlorës”, si të dytin mbas tyre*



NUNTIATURA APOSTOLICA  
IN ALBANIA

Tiranë, 14 Korrik 2008

Të nderuar Zotërinj,

dëshiroj t’ju bëj me dije se Ati i Shenjtë, Papa Benedikti XVI, e ka marrë letërën tuaj dërguar së bashku me materialin mbi Gjergj Kastrioti Skënderbeun dhe Pal Engjëllin.

Sekretaria e Shtetit e ka ngarkuar Nunciaturën Apostolike që t’ju shprehë falenderimet së bashku me urimet më të mira për punën tuaj në të ardhmen.

Me nderime të veçanta.

Mons. Giovanni Gaspari  
Mons. Giovanni Gaspari  
I ngarkuari me Punë a.i.

Shoqata Atdhetare – Dukagjini  
Lagjia Vojo Kushi  
Rruga Çlirimi, Pall. 1261

SHKODER

Arkivin e Vatikanit, mbi këtë kurorë mbretërore dhe festën e kardinalit, sepse duhet të ishte i pamundur një premtim kaq i madh, të ishte bazuar, thjeshtë mbi një bllof?

B) Si e interpretonin e justifikonin kanonikët e kishës katolike, këtë çështje madhore për nacionin tonë?

C) Kishte ndonjë mënyrë korrigjirregullimi qoftë edhe retrospektive, sepse nuk ishte e drejtë që për një incident natyral vdekje të Papës Piu II, për një koïcidencë thjeshtë burokratike e interpretative, të ngeleshim një vend pa mbretëri e mbret të unifikuar, vetëm si një Principatë me një Princ feudal krahinor?

Siç vërtetohet nga dokumentacioni, mbas edhe disa kontaktimeve, na u dha një përgjigje inkurajuese... për ma tepër na u sugjerua verbalisht se, edhe pa filluar kërkimet në Arkivat e Vatikanit, kjo çështje me sa dukej, e kishte një zgjidhje brenda në Albani – Shqipëri. Dhe në fakt, ne e kishim ngritur, trajtuar dhe më shumë kishim këmbëngulur për këtë zgjidhje...

Por, ndërkaq me keqardhje të madhe konstatuam, se, qarqe të fuqishme ish dhe neo otomaniste, segmente ekstremiste fetare sunite e bektashie, bashkangjitur me ndonjë bisht servilësh rajallëku ortodoks e katolik, segmente filo zogiste, filo balliste të ndryshme, neofashiste dhe deri kasta sunduese demokrate “evropiane” hipokrite e PD-së dhe atyre neoenveriste të Ps-së, po na e dashkan si “legjitim”,

*Ja se çfarë sajoni heraldistët e Zogut I të Shqypetarëve*



Mbretin Ahmed Zogogllin I, "Reformatorin e Madh Perendimor", si "Mbreti i Shqypitarve", si "mbreti trashigimtari" i Kurorës së Kastriotëve, me inci-alet AZ, flamurin e tij me shqiponjën e ashtuquajtur anapulla edhe si forma klasikegjante, si flamurin e kombit/kavmit islamik dhe të republikës shqiptare...

Pretendohej se, me antarësimin e Shqipërisë në Konferencën e Vendeve Islamike, mbas "Dërgatës së Xhedahut" dhe me Kush-tetutën e vitit 1998, këto diskutime tashmë ishin mbyllur dhe ishte vendosur një farë Kararnameje e Talimati, për shekullin e ri! Në fakt kësaj Kushtetute, njeriu më uluritës aso kohe i kishte gjetur plot 100 copë gabime, ndërsa për paradoks sot çohet në bisht për mbrojtjen e po asaj Kushtetute, që unë guxoj ta quaj me plot gojën, antievropiane!

Për rihapjen e ridiskutimin e këtyre çështjeve kaq delikate e madhore, ndër të tjera, ne botuam disa artikuj (Shih, gazeta, "Dukagjini", art., "Një përgjigje historike", nr. 58, shtator 2008, f 2; gaz. Shqipëria Etnike, "Papa Benedikti XVI, i kthen përgjigje studiuesit shkodran Agron Luka – Çështja po shyrtohet dhe hetohet në Arkivat e Vatikanit", 21 shtator 2008, f 10; Gazeta, "55", art., "Benedikti XVI, letër Shoqatave "Dukagjini" dhe "Integrimi në Evropë" për studimin e studiuesit Agron Luka", dt. 27 shtator 2008, f 8; "Përkrenaria e Skënderbeut me titullin Mbret – Rex i albanëve dhe



Helmetë / Përkrenare e mijvjeçarit I p. K. e gjetur nga zbulimet arkeologjike në Itali

epirotëve dhe helmata epirote-maqedone në një monedhë të basileusit Trifon (142-138 p.K.)", gazeta Shqipëria Etnike, 4 mars 2012, f 10; Shih për këtë studim, edhe A. Vataj, "Gjithçka që thuhet ... për Përkrenaren e Skënderbeut", gaz. Koha Jonë, 25 tetor 2016, albertvataj.com)

Aktualisht, ka argumentime, fakte e literaturë të mjaftueshme për të vërtetuar fabrikimet, falsifikimet, manipulimet, improvizimet tendencioze etj, deri edhe në

pozita sharlatanizmi, karnivaleske e donk-ishotizmi, filluar qysh nga etimologjia "e Zogut të Shqiponjës", te lidhjet gjenealogjike përmes Toptanëve, te përpjekjet për kapjen e fronit e trashigiminë e gjakut dhe deri te kopjimet e përvehtësimet e përkrenares, improvizimet e formave të shqiponjave të flamujve etj.

Ziliqari Enver Hoxha, do të t'i hapte Mbret Zogut, ende pa ardhur mirë në pushtet, një garë konkurruese të gjithanshme, duke marrë shkas nga improvizimet, falsifikimet e Zogut I dhe historianëve të paguar prej tij, për të paraqitur kontributin e Xhemal Pashë Zogogllit si këshilluesi e udhërrëfyesi i Ismail Bej Vlorës, për ta paraqitur edhe kontributin e e tij si, "koloneli 17 vjeçar dhe muhtari i Matit", Ahmet Muhtar

Beu dhe deri te gjeneralissimi Feldmarshalli Nalt Madhija e Tij, që betohej me të djathtën mbi Kur'an-i dhe me të majtën mbi Bibël!

Nuk ka patur asnjë të drejtë as trashigimtare e as të justifikuar ligjore, i vetshpalluri Mbret, të përvehtësonte dhe të adoptonte simbolet heraldike të heroit nacional Gjergj Kastrioti Skënderbeu! Zogu I, kishte porositur një kopje Përkrenare prej bakri të rrahur, kopje e Përkrenares që ruhet në Vjenë, ndërsa thuhet që edhe

mjeshtri Sotir Buneci i kishte pregatitur një të tillë kopje Enver Hoxhës... Me këto veprime këta karagoje dhe ndjekësit e sotshëm që sajuan edhe një Gardë honorifike me veshje kombëtare, me Pelarina të kuqe e opinga dhe me Përkrenare të Artë mbi kokë, shëmbëllojnë si Kalorësit e Arratisur me Përkrenaren/Legenin e Mambrinit...

Enver Hoxha, duke e hequr krejtësisht "kolonelin e muhtarin 17 vjeçar" fare edhe nga fotografia e Mëvehtësisë, përkundrazi paraqiti "kontributet" e Beqir Hoxhës për 1878, "kontributet e jashtëzakonshme" të Baba Hysen Hoxhës, beledijereizit mullah ateist me sarëk të bardhë, të cilin e cilësoi jo vetëm si një nga figurat më kryesore tok me Ismailin Mjekërbardhë, por edhe si Krijuesi i Fesë së Re të Shqiptarisë, nga 1908 e deri te 1912 e përtej... Ndërsa veten e tij ndoshta e rradhiti edhe pak më lart se Pejgamberi dhe ndoshta Konstelacioni Yjor i tij me 5 Germa, shkonte edhe mbi Arshin e Qafës së Dynjasë, atje te Mjegullnaja e Shqiponjës, ku Universi po zgjerohet ...

Fillimisht edhe Enver Hoxha kopjoi dhe nuk i luajti formë shqiponjat zyrtare, që mbas disa eksperimenteve, kishte vendosur mbretëria zogiste. Pak më vonë filloi t'ia ndryshonte paksa formën, për të vendosur një individualitet të tijin. Kushtetuta e vitit 1998, me kompromisin PD-PS, e lëvizi edhe një herë akoma formë shqiponjën e ashtuquajtur si "klasikegjiantja" nga propozuesit ekspertë flamurexhinj/bajraktarexhinj të PD-së më 1991 ...

Me shpresën se një ditë, të gjitha padrejtësitë, falsifikimet dhe imponimet kryesisht të regjimeve të shek XX, ku dallohen karagojëzët Zogu dhe Enveri, do të korrigjohen duke shkuar në vendin e natyrshëm, le të shpresojmë se edhe ne kemi hedhur një kontribut modest, në themelin e një Shqipërie Albanie të antarësuar e integruar në komunitetin e kontinentin Evropian.

# TURRA E NDEZURA T E DRUVE NË DRENICË NË DUSH I AKULLT PER KOSOVËN

Prele Milani

Copëtimi i Shqipërisë është vetëm një kokërr padrejtësie nga thesi i mbushur që të plotfuqishmit e botës u kanë bërë të vegjëlve dhe të pa mbrojturve në histori.

Rrëketë e gjakut të pa tharë akoma në Kosove janë sa fshikëza e një shushunje të etur për gjak në oqeanin botërorë të gjakderdhjeve vampire.

Urtësia shekullore na mëson se:- Plaçka nuk të bën konak. Gjënë e plaçkitur nuk e gëzon mbasi një ditë do mbesë në fyt. Serbia nuk e ka merituar kurrë Kosovën dhe shqyrr që historia u vetëkorrigjua. Por ne nuk e shkruam historinë e mëvetësisë në kohën e duhur .

U.Ç.K formacioni më pararojë i pavarësimit të Kosovës në mënyrë heroike ndezi një pishë historike, por Vullakni përvëlues erdhi si bekim i SHBA-së.

Pavarësia nga konjunkturaturat ndërkombëtare nuk e plotë as shëndetshme sikur fitohet nga faktori i brendshëm prandaj dihet se në vrimat e sitës ndërkombëtare



ka rrjedhur jo pak paskaj etnik , por ama kemi fituar një shtet.

Me keq ardhje konstatoj se pas 10 vitesh nga konstituimi i Pavarësisë, Kosova nuk është në qell as në tokë. Shpesh duket se

nuk di çfarë të bëjë me pavarësinë e vet duke rrotulluar si mulliri pa kokrra në një lumë retorikash nacionaliste konfuze.

Në dukje ka një lëvizje të moderuar evropianiste , por në thelb shfaqen ten-

dencia inerciale drejt Anakarasë apo çuditërisht edhe me përtej drejt botës arabe.

Nuk është dinjitoze që pas një lirie të dhunuar të hiqemi si të fortit e Ballkanit kur nuk jemi as nuk mund të bëhemi të tillë.

Blllokimi i rrugës se Presidentit të moderuar Vuçiç në Drenicë është vetë gol në portën Kosovare.

Paqa është më mirë se lufta. Fatmirësisht paq me frytdhënëse per kosovaret kurrë nuk ka patur.

I humburi i madh nga kjo paq e bekuar është Serbia.


Atëherë çfarë treguan sot ata shqiptare 100 karaç që ndezën turrat e druve ndaj njeriut që e di mirë se Kosovën nuk mund ta kthejë kurrë më orbitën serbe dhe defakto po ecën rrugës me pengesa por tëpa kthyeshme të njohjes se Kosovës?

Zjarret e Drenicës ishin një dush i akullt per Kosovën në sy aleateve ndërkombëtare dhe një gur më shumë në duar e radikalistve serb që janë gati ta kalin në turrën e druve Vuçiçin e këdo që njeh sovraninë e Kosovës .

# Ne kemi nevojë për Lukën,jo Luka për ne!

Më 26. 08. 2018, në Malësia e Madhe u kujtua të nderojë me titullin "Qytetar nderi", madhështorin Lukë Kaçaj, njërin ndër më të ndriturit e kombit tonë, birin e saj që ngrihti në lartësinë e qiejve vlerën e kësaj treve "Nderi i Kombit", i cili kur u nderua me titullin më të lartë nga ish-Presidenti Topi, ku do të zinte vendin e dhjetë, në 11-shen e kombëtares "Nderi i Kombit" së bashku me yllin e futbollit shqiptar, Panajot Panon. Kurrë nuk jam ndjerë më i paplotësuar brenda vetvetes, si në rastin kësaj ftese të këshillit bashkiak M. Madhe, si kjo e sotnja, si kryetar i shkrimtarëve dhe artistëve malësorë, që Lukë Kaçajn, artistin e madh e ka anëtar nderi prej 12 vitesh. Do të pyesni pse?! Ja përgjigja! Për neglizhencën tonë brenda vetes, për seriozitetin që na mungon në kohën e duhur në raport me vetveten. Plot 12 vite më parë shoqata jonë, personalisht si kryetar i kësaj shoqate dhe si kritik letrar dhe gazetar nuk lashë media të shkruar të "të gjithë kraheve" për të sensibilizuar, (larg antikomunizmit dogmtik, të cilit për ironi nuk i shpëtoi as qëndrimi provincial ndaj Lukës), që të kujtohemi për Lukën. Të gjitha mediat ma botuan fjalën, apelin tim, madje edhe librin tim kushtuar Lukë Kaçajt, kurse ata që heshtën qenë, mjerisht, M. Madhe, çuditërisht Bajza që e kishte djalin e saj, pushteti lokal atje bëri shurdhin duke refuzuar kërkesën tonë institucionale për të ligjësuar sheshin ku mendonim të vendosej monumenti Artistit të Madh malësor, edhe pasi dërgova deri arkitektin, mikun tim prof. Gëzim Uruçin, sikurse mora përsipër të siguroja, me mbështetje të miqve tanë e të Lukës, vlera finaciare që do t'i tërhiqim përmes kishës së Bajzës, gjithçka i takonte që nga shpenzimet për zhvarrosjen (Kurbin dhe

Tiranë) ku ishin dhe pastaj varrosjen e tij e të Anës së tij të shtrenjtë në vendlindjen e Lukës, në Kaçaj, krahas ngritjes së monumentit në qendër të Bajzës për të vënë në jetë amanetin që na la I Madhi



Kaçaj: "Kadri, kam bindje dhe besim të plotë se trupi im do të pushojë një ditë në Bajzë, atje kam shpirtin, vetëm atje ky shpirt im mund të prehet i qetë!" Madje me devizën: "Ne kemi nevojë për Lukën dhe jo Luka për ne" së bashku me miq e shokë të mi e të Lukës, ku do të kujtoja me shumë respekt prof. Zef Çobajn, prof. Fadil Krajën "Mjeshtër i Madh", prof. dr. Ahmet Osjen, prof. Gëzim Uruçin etj, si kurse edhe të afërmin e Lukës, Salvador Kaçajn të cilët nuk kursyen asgjë deri që atij iu dha titulli "Nderi i Kombit", ku pata nderin të jem i ftuar protokolli nga Presidenti I Republikës, prof. dr. Bamir Topi. "Ndera e askujt, - thotë populli ynë, - nuk kthehet mbrapsht, sado e vonë qoftë", çka

sot më bëri, që në fjalën time, të shpreh respektin për këshillin bashkiak dhe bashkinë Kopluk për dhënien e titullit "Qytetar nderi" Lukë Kaçajt, por mjerisht e pamjafvueshme ndaj obligimit tonë si M. Madhe.

Le të shpresojmë që ky akt le të jetë spuntoja e parë serioze, institucionale, si M. Madhe për të plotësuar amanetin që na la Luka, biri ynë, malësori i lavdishëm dhe biri besnik i gjithë Shqipërisë, ndryshe amanetin e kësaj figure të përmasave botërore, siç e cilësuan edhe diskutantët e kësaj ceremonie, prof. Zef Çobaj, Nikola Spathari dhe Kadri Ujkaj pas fjalës së kryetarit bashkiak, Marinaj, që i dorëzoi titullin në fjalë të afërmit të Lukës, z. Gjekë Kaçaj. Luka ishte artisti i madh, që kurrsesi nuk pranoi t'ia kthente shpinën vendit të vet përballë ofertave nga më të majme apo më të çuditshme, që iu ofruan në kontekstin e Shqipërisë së izoluar nga bota. "Ky vend me shkolloi deri jashtë

shteti, këtij vendi do t'i shërbejë deri në fund të jetës sime, më thoshte gjatë intervistës me të, plot dinjitet dhe krenari kolosi Luka". Lukë Kaçaj, lisi i madh, që nuk e shembte dot "Era", edhe pse e goditi jo pak, nuk kurseu asgjë gjatë gjithë jetës së Tij duke manifestuar kurdoherë: KULTURË, PROFESIONALIZËM DHE DINJITET. Jo pak, por 18 vite dënimi, saktësisht 5 vite në qeli dhe 13 në punë korrektorjese, hoqi i madhi Lukë Kaçaj, megjithatë kurrë nga goja e tij nuk hodhi baltë ndaj askujt, as në komunikimin e lirë me të te kafe "Sazani" Shkodër, ku rrinim së bashku, as kur e ftova në Tv-1 Shkodra me rastin e jubileut të lindjes së Tij. Luka e urrente si përbindësh politizimin, ai ishte i lindur përsosmërisht si artist i madh. Prandaj sot, për mua, titulli që iu dha që një rutinë e njohur në trevën tonë, që, së paku para meje, personalisht dhe profesionalisht, nuk thotë asgjë për Të papërsëritshmin Lukë Kaçaj përpara borxhit të jashtëzakonshëm, që ne kemi ndaj djalit tonë "Nderi i Kombit" me të cilin do të krenohen ndër shekuj edhe muret e konservatorit "Çajkovskij" në Moskë, siç do të shprehej titullari i atij konservatori, ndërkohë që Lukës po i dorëzonte diplomën e nderit, në qershor 1955, për rezultate të shkëlqyera dhe si njëri nga 800 anëtarët e nderit të Balshoi Teatrit. Jo rastësisht, duke kujtuar se monumenti i Lukës mund të nderonte çdo shesh qëndror të Evropës, vendosja e tij në qytetin e Koplukut, kryeqendrën M. Madhe "Nderi i Kombit" do të ishte reagimi ynë më dinjitoz, nëse e kemi seriozisht me Vetveten.

**Kadri UJKAJ**  
kryetar i shoqates "Shkrimtarët dhe Artistët, M. Madhe

poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi

**VARGJE ZEMRE**


**PER ROBET ELSIN**

-Në 1 vjetorin e vdekjes-

Datë që nuk harrohet,  
Në vite do përkujtohet,  
Në altarin e historisë do të rreshtohet,  
Një akademik kanadez në Theth varrosset,  
Me dëshirën e zemrës së tij,  
Me u përjetësue n'Alpe, n'Shqipni,  
18 tetor dymijë e shtatëmbëdhjetë,  
Datë e ligjërueme, në Theth,  
Dr. Robert Elsie origjinë gjermane,  
Diplomue në universitete europiane,  
Profesor i nivelit të lartë,  
Punoi 11 vjet në Tribunal në Hag,  
Albanolog e diplomat shkencor,  
Përsonalitet unik botror,  
Bani emër puna e aftësia e tij,  
10 vjet n'Ministri të Jashtme në Gjermani,  
Disa vite punoi në Kosovë,  
Shumë aktivitet zhvilloi,  
Antar i Akademisë së Shkencave punoi,  
Me vullnet e dëshirën e interesimit,  
Me shue etjen e hulumtimit,  
Shqipërinë e vizitoi në kohën e komunizmit,  
Kur ndryshoi sistemi në viti 1990,  
Rikthehet në Shqipëri me shpresë,

I banoi dëshirat realitet,  
Studioi alpet e bregdet,  
I vlerësoi me shpirtë e zemër,  
Këtij realiteti i dha emër,  
Në Europë e bëri shembull,  
E reklamoi këtë pasuri,  
Thethin e quajti krenari,  
Mbretin e Alpeve në veri,  
Në zemër krijoj hartë e në mendje ditar,  
Alpet Shqiptare i quajti "Thesar",  
Jetën e kaloi me penë në dorë,  
Botoi libra në Shqipëri e në Kosovë,  
Me këto Alpe është dashurue,  
Thue aty është lind e jetuar,  
Kjo dashuri se la rehat,  
Në mendje e zemër ruante merak,  
Në bisedë me shokun e vet,  
Sinqerisht atij ju shpreh,  
Due me të lanë një amanet,  
Shpirti e zemra kanë vullnet,  
Kur të më ndajnë jeta me ty,  
Me më varrosë dua në Shqipri,  
Atje në Alpe në veri,  
Në Thethin burror, me lavdi,  
Me ata burra që bënë histori,  
Simbol i trimave në veri,  
Aty shpirti më gjënë qetësi,  
Me vëmendje me më dëgjuar,

Sado pak me të informuar,  
Për ato Alpe në Shqipëri,  
Kullat, kështjella me frangji,  
S'mujti kush në dorë me i shti,  
U ruajt besa, ndera e trimëria,  
Shumë e shtrenjtë ishte liria,  
Gjithmonë dolën fitimtar,  
Në luftë me hasmin ballë për ballë,  
T'rreptë me të marrë gjak në vetull,  
Gjoksin gjanë afër një metër,  
Mustaqet të gjatë deri në vesh,  
Armën në dorë qemerin ngjeshë,  
Edhe kreshtat ruajnë madhëstsinë,  
As në verë bora nuk shkrinë,  
Ato male mbulue me pyje,  
Të zbukurueme prej natyre,  
Ka ujëvara, bukur ushtojnë,  
E lumenjtë freski lëshojnë,  
Në lëndina lule plot aromë,  
Me ato mrize, ku pushonë zana,  
Me djem e vajza vazhdon kënga,  
Gurrat ujin e ftohtë si borë,  
Blegron oqiçi e tingëllon kumona,  
Në majat e nalta shkon jehona,  
E zigtë bukur cicërojnë,  
Edhe plakun e rinojnë,  
Bukur dielli lëshon dritë,  
Aty populli ka traditë,



Me ruajt zakonet dhe liritë,  
Shtrihen malet varg kunorë,  
Nga Vermoshi, Theth e Valbonë,

◀ Në ato male me pyje e shkropa,  
Shumë e bukur bëhet jeta,  
Gra burrneshja me xhubleta,

Burra trima si azgana,  
Vesh me tirq e xhamadana,  
T'urtë në kuvend e t'fortë në mejdan,  
S'duruan krajl, mbret e sulltan,  
Si kreshnikët në luftrat e motit,  
Dhanë natyra dhunti prej zotit,  
Nëper oda rrinë burrnia,  
N'krye të vendit asht paria  
Bahet kuveni e pleqnia,  
Jehon kënga e çiftelia,  
Për krishnikët që rritë malësia,  
Me urti vazhdon muhabeti,  
Si e lejon rregulli e lezeti,  
Te oxhaku rrin manxeri.  
Atje bukur mbështetë te muri,  
Shkëlqen sofa, skalit prej lisit,  
Nera e mikut dhe e fisit,  
Sofër buke plot bujari,  
Gjithmonë gati në çdo shpi,  
Me respektin e mikpritjes,  
Në çdo kohë të natës e të ditës,  
Dhe fjalë burrnore e të sinqerta,  
Mirë se erdhe e mirë se të gjeta,  
Ruajtën ligje e zakone,  
Kanë dhanë bukë, besë e norë.  
Thethi ka vlera historike,  
Lindë e rritë janë me shqipe,  
Me ato shqipe dykrenare,  
Rrinë krenare në ato male,  
Jetuan n'liri qindra vjeçare,  
S'kërkuan besë, nore, as falje,  
Pjesë e pandame e jetesës,  
Me Dukagjinin e pushkës dhe të besës,  
Jnë kalaja e qëndresës,  
Nderi e lavdia e gjithë trevës,  
O shoku im i gjithë jetës,  
Këto janë fakte e të vërtetës,  
Në shumë shtete kalova e studiova,  
Si kto alpe nuk shijova.  
Një natyrë me vlera të mëdha,  
Kurr si këto nuk kisha pa,  
Mëndja e shpirti më kanë kërkuar,  
Në ato Alpe për tu përjetësuar,  
Vend ma të bukur ska për mue,  
Këtë dëshirë e amanet,  
Ja plotësoi shoku i vet,  
Me mirënjohje e ligjëroi shteti,  
Me ceremoni e priti Thethi,  
Ceremoni kortezi mortore,  
Me respekt pritje madhështore,  
U varros sipas zakonit,  
Sikur trimat dikur motit,  
Me fjalim te kryet e vorrit,  
E vlerësuan për gjithë cilësite,  
Për ato vlera me meritë,  
Me urtë e bekue në kishë,  
Arkivoli dorë më dorë,  
Mlue me lule e kunorë,  
E flamurin me shqiponjë,  
Të gjitha nderimet si burrë kombëtar,  
Me jelek e kapuç të bardhë,  
E nderuan me "titull nderit",  
Me respekt banorët e Thethit,  
U ligjruen në altarë të kishës,  
Pusho n'paqën e përjetësisë,  
Me ata burra të sakrificës,  
Që shkruan faqet e historisë.  
Ne, dukagjinasi në emigrim,  
Me mirënjohje e falënderim,  
Për atë respekt e ceremoni,  
Për Thethin tonë, gjithmonë lavdi.

**Pjetër Gera,  
Gusht, 2018  
Bruksel**

# TË KËNDOFTË ZEMRA NIKOLLË NIKPRELAJ

KONCERT MADHËSHTOR NGA KËNGËTARI NIKOLLË NIKPRELAJ, NË ZEMËR TË ALPEVE

Pas ndryshimeve demokratike, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në shumë shtete të Ballkanit, u krijua mundësia e marrëdhënieve më të mira mes tyre, në mënyrë të veçantë në fushën e marrëdhënieve kulturore, artistike e sportive etj.

Këto ndryshime, natyrisht sollën bashkëpunime të reja, por nëqoftëse bëhet fjalë për Shqipërinë, Malin e Zi, Kosovën e Maqedoninë qenë më të lehta e më të realizueshme, sepse këndeje e andej kufirit jetonin shqiptarë që nuk kishin asgjë të ndarë në kulturën dhe traditën e tyre, përveç një kufiri politik ndërshtetëror.

traditë, por edhe u bë një misionar për realizimin e kësaj detyre.

Nikollë Nikprelaj u bë shpejt një ndër artistët që me zërin e tij dhe krijimtarinë e tij, do të zgjonte banorët e Alpeve Shqiptare e jo vetëm nga "gjumi", që ata kishin rënë. Ai e përtëriu këngën folklorike të Malësisë, ai i hoqi "pluhurin" lahutës së lashtë që gati ishte harruar në këto zona.

Një punë e tillë nuk ka qenë aspak e lehtë, por gjithsesi ai e ka realizuar si një artist multidimensional, si këngëtar, si instrumentist i të gjitha instrumenteve folklorike, lahutë, çifteli, bilbil, fyell etj,

jo vetëm, si dhe vallet e mrekullueshme shqiptare, përplaseshin me jehonë në shpatet dhe luginat e këtij amfiteatri madhështor, duke përcjellë tek spektatorët këngën dhe muzikën e traditës, por edhe atë bashkëkohore.

Nikollë Nikprelaj kishte menduar për të gjithë. Ai në mënyrë tradicionale e hapi këtë koncert me një këngë të lashtë kushtuar vendlindjes, duke qenë në krah të babait të tij Nosh Grishi (Nikprelaj) 91 vjeçar, në interpretimin e një kënge "maje krahu" dhe për të vazhduar i palodhur për disa orë me zërin e tij brilant dhe reper-



Këtë e tregon më së miri edhe shkëmbimi i grupeve social-kulturore në mënyrë të ndërsjelltë dhe kjo tregon arsyen se pse banorët shqiptarë në Tuz, Ulqin e Tivar, në Tetovë, Shkup e Ohër, në të gjithë Kosovën e njohnin e i këndonin këngët shqiptare, i kërcenin vallet shqiptare, i njohnin këngët e tyre dhe vallet e tyre.

Pavarësisht nga kufizimet e njohura politike të asaj kohe, pavarësisht nga censura ideologjike, këngët dhe vallet shqiptare nuk doganoheshin e çdoganoheshin në kufinj të ndërsjelltë.

Kjo tregon mbi të gjitha se tradita shqiptare mijëra vjeçare do të vazhdojë përjetësisht e pacënuar nga sistemet që shkojnë e vijnë.

Mu desh të shkruaj pak gjatë në këtë hyrje të këtij shkrimi, sepse personazhi që unë kam zgjedhur është një ndër përfaqësuesit që me talentin dhe zërin e tij, e pse jo, edhe me guximin e tij, që nga viti 1983 shkëlqen me krijimtarinë dhe interpretimet, për të ruajtur traditën folklorike të malësisë shqiptare, të asaj treve aq të pasur, në mënyrë që ajo jo vetëm të mos humbasë, por të bëhet një urë lidhëse mes shqiptarëve të Kelmendit të ndarë përgjysëm.

Ky personalitet, dhe e meriton ta quajmë të tillë, quhet Nikollë Nikprelaj, i lindur në Triesh, që në rininë e tij, jo vetëm i vuri detyrë vehtes ta mbante të gjallë këtë

por edhe si krijues i këngëve të reja që gjithmonë kanë ngritur peshë ambientet shqiptare, patriotike e familjare, jo vetëm në trojet tona, por edhe në Europë, SHBA e Australi.

Për të bërë këtë shkrim, i cili mendoj se ka vlera të mëdha për njohjen e aktivitetit të këtij këngëtar, unë nuk pata nevojë të marrë të dhëna për të, pasi pata fatin të marrë pjesë në koncertin madhështor që ai kishte organizuar me rastin e mbylljes me shumë sukses të sezonit veror, të aktivitetit të tij artistik, në vendlindjen e tij Triesh dhe largimit të emigrantëve për në vendet ku jetojnë e punojnë.

Unë isha atje si një ndër spektatorët më dashamirës të tij dhe ndoqa nga afër atë koncert madhështor që kishte organizuar. Jam i mrekulluar dhe nuk gjej dot fjalë ta përshkruaj këtë festë të madhe mes malesh, ku pjesëmarrja e fansave, dashamirësve dhe bashkëqytetarëve e tij ishte befasuese.

Para fillimit të koncertit ndjehej heshtja madhështore që diktojnë malet dhe luginat, por për pak kohë para se të fillonte ai, kjo heshtje u thye nga zhurmat e makinave luksoze dhe grupeve të njerëzve që vinin nga çdo anë, për të treguar se në këto male ka jetë, ka gjallëri, ka gëzim.

Skena madhështore ishte instaluar në një ambient mahnitës të Alpeve Shqiptare. Tingujt e muzikës së bukur folklorike dhe

torin e mrekullueshëm, të shoqëruar nga një orkestër jashtëzakonisht profesionale, nën drejtimin e maestro Samir Beqaj në tastierë, Arsid Çeka në perkusion dhe Kristian Gusho në violinë.

Në këtë koncert, ashtu siç e përshkruam edhe në fillim, tradita malësore kishte simbolet e veta, kishte vazhdimësinë e saj, kishte brezat që trashëgojnë njëritjetrin. Në skenë, para një piste gjigande, ku nata ishte bërë ditë, spektatorët pjesëmarrës përcillnin me duartrokite gjyshin 91-vjeçar, të birin e tij Nikollën dhe artistin më të ri shumë të talentuar djalin e Nikollë Nikprelës, Albin Nikprelaj, një këngëtar i shkëlqyer.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe përfaqësues të Komunitetit të Tuzit, intelektualë të kësaj krahine, sponsorë, dashamirës të artit e kulturës, si dhe qindra e mijëra spektatorë, ku binte në sy, në mënyrë të veçantë mosha e re e tyre.

Koncerti i kësaj mbrëmje magjike u regjistrua nga televizioni "Boin" i Tuzit, nga kameramani Mark Ujkaj dhe gazetarja Fedra Raicevic.

Natyrisht, sukcesi dhe meritat për të gjallëruar jetën në këtë trevë e kanë gjithmonë artistët, në këtë rast këngëtarit kaq i dashur i kësaj treve Nikollë Nikprelaj.

**RAMAZAN ÇEKA, Gusht 2018**

## Kanga IX

Heretikët. Para se të hyjnë në rrethin e tyne, poetët shohin Furitë (Erinitë). Me ndihmën e engjëllit qiellor dyert hapen lehtësisht. Si hyjnë në Dite, Virgjili e Dante gjenden në një fushnjë mbushë me vorre, që përbrenda digjen flakë e së jashtmi janë të kuquna gacë. Nga mbrendësia e tyne dalin ankimet e gjamshme të heretikëve. Ata janë të ndamë në grupe, simbas sekteve e përkatësisë.

Koha: e shtunë, 9 prill 1300, mëngjes heret.

Vendi: Rrethi VI i Ferrit, pranë derës së Dites.

Personazhet: Virgjili, Dante.

Prezentë: Furitë - Erinitë (Megera, Aleto, Tisefon), engjëlli qiellor, demonët.

- 3 Ngjyrimi që prej frike jashtë m'që shtye, tue pa drejtuesin mbrapsht të bante kthim, shtrëngoi atë që t'veten mbrendë me e ndrye.<sup>1</sup>
- 6 U ndal e me kujdes ka ba përgjim, se s'ishite e mundun sytë ma larg me i çue në ajr të zi e t'thuktin mjegullim.<sup>2</sup>
- «Pra, ndeshjen duhej ne me e pasë fitue», - filloi, - «në mos..., por Vetë premtime më ka.
- 9 Oh, prej se m'ngjatet, m'duket i vonue».<sup>3</sup>

1 **Ngjyrimi** - Ngjyrimi i frikës është zbehja, zbardhimi (krahaso K.IV, 14-21). "Për të kuptue ma mirë këto vargjet e para, them se autori, tue na e rritë kështu ma fort efektin emocional, po na thotë se Virgjili ishte ndezë për shkak të refuzimit ofendues të demonëve e, kështu, si rrjedhojë, ishte kuqë nga zemërimi. Për shkak të kësaj ngjyre që kish marrë fytyra e tij, Dante është pushtue nga frika që të ban akull. Kështu, Virgjili, tue pa se fjalët ngushëlluese e kishin qetësue Danten sepse shihte qartë se nuk kish braktisë frikën, zbuti tonin dhe përpunoi zemërimin, në mënyrë që ky të mos kishte aq frikë. I gjithë ky ndryshim i Virgjilit na bahet i dallueshëm me anë të ngjyrës së fytyrës së tij që, me të pa Danten të bamë bardh, zbutë të kuqen e vet, mposht zemërimin" (Benvenuti, f.231). Kjo sjellje e Virgjilit, është një prej shumë të tillave kujdesore ndaj Dantes, qoftë në këtë situatë të vështirë, qoftë në të tjera raste, siç kemi pa e do shohim përgjatë Kantikut.

Një fakt është për t'u shënuar në kreun e kësaj kange. Ashtu si në të maparshmen, edhe këtu fabula vazhdon pa u ndërpre nga kanga e maparshme. Por, poeti këtu nuk e nis atë me tue vazhduar ku e kam lanë (seguitando), pra me përcjelloren e famshme, çka u ka qitë aq punë komentuesve përgjatë shekujve... Bajmë një pyetje të thjeshtë, meqenëse është nja janta dukuni, pra vazhdimi i fabulës pa ndërpre nga një kangë në tjetrën, pse poeti nuk e nis atë tue përdor përcjelloren?! Mos vallë Bokaço ka të drejtë kur thotë se aty, në fundin e Kangës VII, poeti e ka ndërpre punën më 1301 dhe e ka rimarrë atë më 1306?! Asht e pamundur me u pozicionue qartazi në lidhje me këtë.

që frika jashtë ma kishte shtye - Frika shtyn jashtë zbardhimin në fytyrë. Ky kuptim është ma i pranueshëm se fytyrën ma ngjyroshi me frikë. Në origjinal pinse është shumë afër me dipinse në formë, prandaj pinse ka shtye të mendojë shumë komentues se mund të mos jetë shtye por thjeshtë shkurtim i dipinse për shkak të metrikës. Por ajo që na ban t'i mësojmë kuptimit shtye (pinse - shkurtim i spinse) e jo ngjyre (pinse - shkurtim i dipinse), është pikërisht fjala ma poshtë (v.3) ndrye. Për kontrast, ajo që shtyhet (del jashtë, në sipërfaqe, në fytyrë) tek Dante, ndryhet tek Virgjili. Si do e shohim, krejt të kundërta janë motivet e ngjyrosjes së fytyrave të dy protagonistëve: ndërsa frika ka shtye jashtë zbardhjen e Dantes, vetëpërbajtja e Virgjilit ka ba që ky të ndryjë përbrenda ngjyrën e vet (skuqë), nxitë nga zemërimi ndaj djajve.

tue pa... të bante kthim - Arsyeja pse Dante frikësohet, është se ka pa Virgjilin të kthejë mbrapsht, pa mundë të bajë një marrëveshje me djajtë. Në sytë e Dantes, kjo ka vlerën e dështimit të Virgjilit. Simbas mendësisë së kohës, thuhet se një ushtri mbrapsht ban kthim kur është mposhtë: i kthen shpinën amnikut.

shtrëngoi atë që t'veten mbrendë me e ndrye - Zbardhja e Dantes për shkak të frikës, ka shtrëngue Virgjilin të përbahet në zemërimin e tij. Për këtë mendojmë se bahet fjalë për skuqje, mbasi në v.121 të kangës tjetër shqetësimi i Virgjilit nuk është tjetër, veçse zemërim (në origjinal m'adiri - ndizem). Asht me u nënvizue origjina e ngjyrave të mjeshtrit dhe dishepullit: njëni për shkak të frikës (e bardhë/verdhë), tjetri për shkak të zemërimit (e kuqe). Fakti që Virgjili zemërohet, është se befasohet nga sjellja e djajve, të cilët duhet t'i kishte kalue tashme e jo nga frika, siç mendon Dante fillimisht. Që nuk i ka llogaritë si një pengesë serioze, dallohet nga mënyra se si shprehet për ta në fundin e kangës tjetër: Kush pengesë m'a gjetë! në kuptimi Po këta, kur u banë kaq trima. Si gjithmonë, Virgjili shfaq një kontroll shembullor të ndjenjave.

2 U ndal... mjegullim - E gjithë tercina transmeton padurimin e një pritjeje. Virgjili është ngri i tani tue përgjue ndonjë zhurmë që t'i japë me kuptue se po ndodh çfarë pret, tue u përpjekë kështu me mbushë mungesën e informacionit që nuk vjen prej syve (v.5).

U ndal - Ndërsa Virgjili përshkon atë segment rruge që ndodhet mes Dantes e djajve, para se të kthehet tek ai, ndalet, përgjon, shikon. Me hetue e me kapë me precizion çdo gjest, çdo detaj, sado të vogël, të njeriut, jo vetëm aspektin fizik të tij, por shpirtin që e ven atë në lëvizje, është një nga tiparet dalluese të poezisë së Dantes.

se s'ishite e mundun sytë ma larg me i çue - Kjo është arsyeja se pse Virgjili dëgjon me vemendje, përgjon: ngaqë shikimi nuk shkonte larg në sipërfaqen e moqalit, ku mbretonte terri i madh e mjegulla e dendun (K.VIII, 12), duhet të përqendrohet në dëgjim.

3 Pra, ... - Perifrazim: Megjithatë..., pavarësisht kundërshtisë së djajve... Me këtë fjalë, dallohet njëfarë dyshimi që përshkon mendjen e Virgjilit për një çast të vetëm, edhe se është ai që e hedh poshtë, tue sjellë ndër mand faktin se Vetë (Ai) ka premtime kalimin pa pengesa të Ferrit. Edhe një herë tjetër, me këtë detaj të vogël, nënvizohet natyra njerëzore e Virgjilit, që e ban atë jo vetëm real, por gjithashtu një personazh shumë afër lexuesit.

ndeshjen duhej ne me e pasë fitue - Siç e thamë, në këtë tercinë shohim Virgjilin, edhe se për një çast, të lëkundet në sigurinë e tij. Ashtu si dhe Dante, në kangën paraardhëse, të cilit nga frika PO e JO në krye i banin ngatëresë (v.111), është edhe Virgjili kalon nga dyshimi në siguri e anasjelltas. Në v.7 nga dyshimi pra... kalon menjëherë tek betejën duhet ta kishin fitue; nga në mos... kalon në ekstremin tjetër por Vetë ndihmë ofruer ka.

në mos... - Kjo reticencë nuk është e shpjgueshme. Lexuesi, ashtu si dhe Dante personazh, duhet të bajë përpjekje ta marrë me mend e ta plotësojë këtë fjali, lanë përgjysëm. Padyshim që kjo fjali shpreh hezitim, çka plotësohet nga çfarë thotë në vazhdim: Nëse ai premtim ndihme do të përbushet, pse kjo rezistencë është kaq e fortë e kryeneçe?! E nëse duhet të kthehem mbrapa?! Por kjo nuk mund të ndodhë, sepse Ai që ka premtime nuk është i tillë. Gjithë çfarë thotë Virgjili - siguria, dyshimi, siguria - e thotë me vete, jo i drejtues

M'u duk se rrekej që mbulesë me i ba fillimit t'kumtit me ç'pasoi ma ndej, që ngjanin fjalë, me t'parat, tjetër gjã; <sup>4</sup>

12

Dantes, por Dantes nuk i shpëton kjo. Skena, fort e ngjashme me atë të një teatri, është e para e shumë të tjerave po kaq të rafinueme e reale, çka e bajnë rrefimin të vërtetë dhe shumë emocionues.

Vetë premtime ka - Virgjili shpesh e ka përsëritë se suksesi i udhëtimit të tyne është vendosë atje "ku mundet me u veprue, / gjithë çka dëshrohet, ma ndej mos e zgjal" (K.V, 23-24). Thuejse të gjithë komentuesit e vjetër mendojnë se këtu aludimi është për Beatricen e cila, si e kemi pa në Kangën II (v.85 e vazhdim), ka zbritë në Limb për të thirrë e dërgue Virgjilin në ndihmë të Dantes, gjendun në një çast dramatik për jetën e tij. Por edhe ajo vetë është shtye nga një forcë madhore. Kështu është ma e drejtë të merret me mend se bahet fjalë për vetë Perëndinë.

Interesant është interpretimi i Butit. Në origjinal Vetë ndihmë ofruer ka e gjejmë me Tal ne s'offerse. Pikërisht s'offerse ai e lexon offerse, çka i ndryshon kuptimin vargut, mbasi fjala në këtë rast do të kuptonte vuejë. Po të marrim versionin që sugjeron Buti, do të kishin, nga kjo Ai vetë do të viente. Kështu, meqenëse dy udhëtarët janë aty me vullnetin e Perëndisë, humbja e tyne do të jetë vuejtë për Atë vetë, prandaj pashmangshëm Ai do të ndërhyjë... Megjithëse joshës ky i dyti, mendojmë se interpretimi i parë është ma i sakti.

Oh, prej se m'ngjatet, m'duket i vonue - Esklamacion, i thanë nën za vetvetes, që shpreh, në mos pasiguri, së paku padurimin në pritje të ndihmës qiellore e cila, përtej çdo prishmënie, do të shfaqet me një mënyrë të mahnitshme. Skena e ardhjes së engjëllit qiellor merr trajtat e një shembulli, ngado ta shohësh, i pasun me sugjerime e refleksione teologjike.

4 M'u duk - Nuk bahet fjalë këtu që Virgjili t'i ketë fshehtë gjendjen e tij Dantes: me pjesën e parë të fjalisë, përmes reticencës (v.8), ai shpreh hezitim, ndërsa me pjesën e dytë mposht hezitimin. Por Dante, në pikë të hallit, ka vu re vetëm hezitim dhe e gjithë vemendja e tij aty është përqëndruar sepse, nga pasiguria e hamendësimeve e Virgjilit, varet jeta e tij. Për këtë arsye, çdo gjest, çdo shprehje ndikon në mënyrë të pashmangshme në gjendjen e Dantes. Kjo është karakteristikë për dy kantikët e parë (në kantikun e tretë do të jetë Beatrice ajo që do ndikojë). Gjendja e Dantes para portave të Dites, përban një çast mjaft të vështirë, në mos ma të vështirën në Ferr. Por, në këtë vështirësi, vihet në provë gjithashtu edhe Virgjili, çka paditë natyrën e tij tepër njerëzore. Reduktimi i figurës së Virgjilit në këto nivele, përballë vështirësisë që tejkalon mundësitë e njeriut, është i qëllimshëm. Me këtë theksohet nevoja që ka njeriu, në raste të tilla, me i lanë vend ndërhyms hyjnore. Kjo vështirësi e pakapërcyeshme është synon, çka në fakt është tema e kësaj kange.

mbulesë me i ba - Pjesa e dytë e fjalisë Vetë ndihmë ofruer ka ka anulue pjesën e parë në mos..., që paditë një gjendje krejt të kundërt: e para pasiguri

ndaj frikën fare nuk ma hoqi tej, sa fjalëve t'cungueme u pata dhanë, kuptim ma t'randë se ç'deshi të rrefejë.<sup>5</sup> «Në t'dhimshmin fund të ksaj humnere t'gjanë a zbriti kush ndojherë nga rrethi i parë, që si dënim veç shpresën kputë e kanë?».<sup>6</sup>

e dyshim për pamundësi, e dyta siguri, besim që përjashton çdo mundësi të dohduni ndryshe.

5 ndaj frikën fare - Si thamë, vemendja e Dantes është përqëndruar tek ajo hije e lehtë dyshimi, shprehë në pjesën e parë të fjalisë së Virgjilit, jo tek tjetra. Kjo është krejt normale në rrethana të vështira: instinkti i vetëmbrojtjes është i përqëndruar totalisht aty ku heton të ketë sadopak rrezik.

fjalëve t'cungueme - Reticensa në mos... (v.8).

kuptim ... të rrefejë - Prej fjalëve të para të Virgjilit, Dante ka marrë ma të keqen e mundshme, pa pasë parasysh çfarë mbas tyne ka ardhë. Frika, prouv nga sjellja arrogante e djajve, e ka shtye të imagjinojë ma të keqen gjë që mund t'u ndodhte në atë vend të Ferrit. Se ç'të keqe ka imagjinuë ai, veç mund të merret me mend, tue pasë parasysh tercinën në vazhdim. Me gjasë, nga në mos..., Dante ka kuptue veç në mos paça humbë rrugën. A thue e din Virgjili rrugën?! Kjo është ma e keqja gjë që një udhëtar mund të mendojë për udhërrëfyesin e vet. Teprinë e gjithë këtij hamendësimi do ta shohim në fund të skenës, kur problemi do të zgjidhet thjesht e dera do të hapet lehtëzi. Tue frigue ma të keqen, e kuptojmë pse fjalëve të Virgjilit u ka dhanë një kuptim edhe ma të randë se ç'martin. Pa nga kandvështrimi alegorik, meqenëse po gatiten me lanë Ferrin e sipërm, për të hy në të poshtmin (ku ndëshkohen mëkate ma të randa), kuptojmë se, në mjedisin e ri, arsyeja njerëzore, edhe se e naltë (Virgjili), është dobipak pa ndihmën e drejtpërdrejt të Perëndisë.

6 a zbriti kush ... nga rrethi i parë - Dante i ban Virgjilit një pyetje në dukje të përgjithshme, për të arritë në një njohje të veçantë: Vallë, a e di Virgjili rrugën? Këtë pyetje Dante e ban tue u përpjekë të fshehtë frikën që e ka pushtue dhe mosbesimin ndaj Virgjilit. Por përpjekja është e pasuksesshme, mbasi zbulohet menjëherë prej tij: pra, rrugën mirë e di, jam tue t'kuvendë (v.30). Kjo skenë, ku Dante shpreh mosbesimin, është një detaj i vogël, por që ngre në maksimum notat e realizmit, jo vetëm të skenës a ngjarjes, por edhe të marrëdhënieve me natyrë atë-bir mes tyne.

që si dënim veç shpresën kputë e kanë - Fjalët e Dantes janë përsëritë e saktë e përshkrimi të mundimit të banorëve të Limbit që Virgjili ban në Kangën IV (41-42): "l'humun e vetëm me kaq të ndëshkuem: / për ç'dëshirojmë, shpresë pa pasë kurfarë". Në dukje mjerimi i tyne mund të konsiderohet mjaft i lehtë por, pa në kandvështrimin alegorik e në kontekstin e jetës reale, në shërbim të të cilës është gjithë kjo poemë, na jep një mesazh mjaft të randësishtëm:









## poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi

**Humorit Shkodran**

Sot jemi mbledhë  
Shokë edhe miq  
Humori ka sjellë  
Mjaft rrush e fiq!

Rrush në pjergull  
I pjekun tanë  
Pa dashje ndrikull  
E shkele mbramë!

Urojmë së toku  
Suksese shumë  
Të fala nga Pinoku  
I keni nga unë!

Kudo në çdo anë  
Në fshat e qytet  
Humori Shodran  
Ka fjalën e vet.

Ky ka një emër  
Dhe lëshon një dritë  
Thellë në zemër  
Shpresën e rritë.

Sido që të jeshë  
Vetëm të gëzon  
Se të ban me qeshë  
E të lehtëson.

Po çoj këtë gotë  
Si djalë i ri  
Se me humor  
Nuk ka pleqni!

**Mikesha ime**

Iken vitët dhe dekadat  
Kur të bleva biçikletë  
Isha i ri, por u plaka  
Prapë me ty kam mbetë.

Unë për ty kam merak  
Të lutem mbaje sekret  
Ti më jep ndihmë në çdo hap  
Edhe rrugën m'a ban të lehtë.

Je e urtë dhe besnike  
Kurrkund shoqen nuk e ke  
Ditë e natë moj mike  
Së bashku shetisin ne.

Shkoi dimni, erdhi Vera  
Veshë e mbathë për bukuri  
Ajo më tha: që biçikleta  
Asht mikeshë për çdo njeri!

**Për ju letra**

Moj e mira bukuroshe  
M'a gëzofsh emnin që ke  
Për nga fisi vjen e moçme  
Por në fakt m'dukesh e re.

Ditë e natë ecë me vrap  
Si prostitutë kalon  
Paske humb shumë karat  
Më ngadalë, ku po shkon?!

Kush asht ai që e di vallë  
Sa të fshehta paska jeta?  
Vjen një gëzim e një hall  
Një me pesë humbi kuleta!

Ju o "misse", "topmodele"  
Paçi fat e lumtuni  
Ju na sollet karamele  
Me gostit disa zotni.

Treti mundi, humbi djersa  
Që mbi ta asht shënue  
Flet me vedi diçka tezja:  
"Kështu paska kenë shkruë"

**Kudo fusha po lulëzon**

Kudo fusha po lulëzon  
Tejpërtej e në çdo anë  
Mister "Tori" po ushton  
E ka ba qelizem tanë.

Rrofsh moj ti e traktorit  
Që dy pëllambë je e gjatë  
Lum ai që prap të solli  
Tokën kurrë s'e le thatë?!

Mbas atij ditë e natë  
E hedhë farën një nga një  
Ajo shkon në tokën nanë  
Dhe jep grunin me kallinj.

Të "kënaqet" syni e shpirti  
kur udhëton me makinë  
Porsi ari shkelqen misri  
Kokra e tij sjell një bimë.

**Alegria**

Pesë vëllazen në malësi  
Shtëpinë e kanë afër një kroi  
Ata janë miqtë e mij  
Kur mërzhitem atje shkoj.

Si gishtat e një dore  
Kanë zanë nga një vend  
Mendjen shpesh e kanë në lojë  
Dhe me qeshë përnjimend.

"Kam një bindje o sokola  
Nuk ka burrë me ma ndryshu  
Tan të mirat që ka bota  
Nuk kanë vlerë pa një gru".

Kurse tjetri u anku:  
"Asht e sertë, por do zbutet  
Ka fillu me e tepru  
Burrit don me i fut tuten."

Ma i madhi tha një fjalë:  
"Ta duem fort njeri tjetrin  
Nga goja të nxjerrim "mjaltë"  
Kjo i duhet sot progresit".

Ai i katërtri pak zeshkan  
Me një bionde asht martu  
Asht e gjatë deri në tavan  
Nuk ka dreq me e pushtu"

Vëlla të vogël kanë Martinin  
Që ma shumë rrin e dëgjon  
Tjetër kund e ka mendimin  
Askurrkujt nuk i tregon.

I pëlqejnë ato livadhe  
Kodrat mbushun me blerim  
Por ma tepër një sorkalle  
Që e prët atje në burim.

**Radha**

Na ishte një herë  
Një burrë i vjetër  
Sot i ndjerë  
Në botën tjetër.

Njeriu i mirë  
Me zemër të bardhë  
Shkrihej në diell  
Ngrihej në acar.

Atje nën shkallë  
Në shi e shtërngatë  
Zinte një radhë  
Plaku i ngratë.

E çonin shtëpia  
Se donin qumësht  
Ndryshe familja  
I mbetej ngushtë!

Kur vjen njeriu  
Në këtë botë  
Nuk pi i "ziu"  
Kurrë me gotë!

Mund të thoni  
Një diçka tjetër:  
Rroftë biberoni!  
Model i vjetër.

Ka thanë bariu:  
Kjo mrekulli  
E ndjek njeriun  
Deri në pleqni!

Pa atë nuk rrinë  
As plaku i shkretë  
E do një "grimë"  
Qumësht të nxehtë.

**Paraja**

Thellë në fund e shpon detin  
Naltë mbi re rrufe kalon

Si një yll shikon diellin  
Në galaktikë kur fluturon.

Pika-pikë djersë kullon  
Për ty lodhet çdo njeri  
Por ndodh që edhe renkon  
Kur ligësi ndien në shoqni!

Moj para të qofsha falë  
Të gjithë botën e gëzon  
Ti edhe plakun e ban djalë  
Me ma të miren e marton!

Të don fort usta Loni  
Gjumi i natës nuk e zën  
Ai për ty si Harpagoni  
Mendt e kresë po i len!

Nëpër gishtat shpejt rrëshqet  
Si ngjala në dy duer  
Për sejcilin asht lezet  
Dhe gur prove për çdo burrë.

Ju rritë ndera e fisi  
Njeriut të mirë kavaljer  
Në Parajsë i shkoftë shpirti  
Që ndau bukën me të tjerë.

Lum ai që i qëndron punës  
Në çdo çast mbledh "flori"  
Paraja e bardhë i del rrugës  
I jep forcë dhe lumturi.

**Qofsh e gëzuar zemërbardhë**

Në mes të korrikut e vapës  
Ishte futur thellë në ujë:  
"Më iku topi në mes të vales  
Ma mer xhaxhi asht i huej."

U hodh not në rresht të parë  
Por nuk mundi t'a arrijë  
Më vjen keq nuk je ma djalë  
Të iken vitët një nga një!

Ke fillue me ardhë pleqni  
Dalëngadalë ecë në kambë  
Na falë shëndet edhe fuqi  
Qofsh e gëzuar zemërbardhë.

Ti na sjell disa sinjale  
Me keqardhje i përmend  
Ata janë telegrame  
Që s'harrojnë askërkend.

Në krye të vendit te oxhaku  
Baca Rexh po bisedon:  
"Ku asht plaku derdhet gjaku  
Mendja e tij kurrë s'gabon!"

A e dini çka m'tha frati  
Kur një ditë e kam takue:  
"Pak shërbim te krevati  
E don plaku nga një grue."

Luigj Temali

**REDAKSIA**

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,  
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja**Mundësoi Botimin:****AV. ANTON KOSTERI**Kryetar i degës së Shoqatës Atdhetare  
Dukagjini, Shkodër